



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
KRYEMINISTRIA

departamenti
dap
Administratës Publike



RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT 2020

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE



*Copyright © 2021, Departamenti i Administratës Publike
Të gjitha të drejtat e rezervuara*



01 LISTA E AKRONIMEVE	4
02 PREAMBULA	5
03 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
04 PROGRESI I STRATEGJISË	9
05 SHTYLLA I: POLITIKËBËRJA DHE CILËSIA E LEGJISLACIONIT	22
06 SHTYLLA II: ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE	30
07 SHTYLLA III: SHËRBIMI CIVIL: MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	36
08 SHTYLLA IV: PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE MBIKËQYRJA	49
09 VLERËSIMI I ARRITJEVE KRYESORE DUKE PERDORUR TREGUESIT	60
10 KOMUNIKIMI I AKTIVITETEVE	61
11 ANEKS I - ECURIA E PLANIT TË AKTIVITETEVE 2018 2022	65
12 ANEKS II - RISKU DHE MITIGIMI	74

AKSHI	AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT
ADISA	AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA
BE	BASHKIMI EVROPIAN
DAP	DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DZHM	DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT DHE MIRËQEVERISJES
EAMIS	SISTEMI I MENAXHIMIT TË ASISTENCËS SË HUAJ
HRMIS	SISTEMI INFORMATIK I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE
IPSI	SISTEMI I PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR TË MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT
IPS	SISTEMI I PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR
KMSHC	KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
KDIMDP	KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
KE	KOMISIONI EUROPIAN
KPI	INDIKATORËT KYÇ TË PERFORMANCËS
ML	MINISTRI LINJE
NC	NËPUNËS CIVIL
OECD	ORGANIZATA PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM EKONOMIK
OJF	ORGANIZATË JOFITIMPRURËSE
OSS	ONE SINGLE SYSTEM (NJË SISTEM I VETËM)
OZHQ	OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM
PBA	PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
PFM	MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE
PKIE	PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN
RENJK	REGJISTRI ELEKTRONIK PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK
RIA	VLERËSIMI I NDIKIMIT RREGULLATOR
SIGMA/OECD	SUPPORT FOR IMPROVEMENT IN GOVERNANCE AND MANAGEMENT
SKZHI	STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM
SNRAP	STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE
TIK	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT




PREAMBULA

**Fjala e znj. Albana Koçiu - Drejtor i
Departamentit të Administratës
Publike**

Viti 2020 ishte padyshim një vit i pazakontë, i shoqëruar me sfida dhe vështirësi të mëdha për të gjithë botën, e për Shqipërinë gjithashtu. Të gjithë vendet, përfshirë edhe ato më të zhvilluara u gjendën të papërgatitura për të menaxhuar situatën e pandemisë globale dhe pasojat negative që derivuan prej saj. Për Shqipërinë kjo situatë erdhi pas një tjetër sprove të fortë, si tërmeti që tronditi vendin në Nëntor të 2019. Megjithatë, pas pothuaj një viti bashkëjetese me mbyllje totale apo të pjesshme, kufizime, rregulla strikte e ndryshime në mënyrën tonë të jetës dhe të punës, Shqipëria tregoi se ja del mbanë të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të kapërcyer çdo sfidë e për të buzëqeshur përsëri.

Sfida dhe prioriteti kryesor gjatë vitit që lamë pas, ishte patjetër ofrimi dhe garantimi i shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor për qytetarët. Megjithatë, sfiduese nga ana tjetër ishte dhe realiteti i ri me të cilin administrata po përballlej, një mënyrë të punuari tërësisht e re, me të cilën duhet të përshtatej sa më shpejt në mënyrë që të vijonte të siguronte mbarëvajtjen e punës dhe ofrimin e shërbime publike cilësore.

Të gjendur në kushtet e kufizimeve të herëpashershme testuam kapacitetet tona institucionale e njerëzore dhe matëm aftësinë tonë për t' u përshtatur me ndryshimin e pashmangshëm, atë të smart-working, duke u kujdesur që efienca dhe performanca e nëpunësve tanë publike të ishte në standardet e duhura. Transformimi ishte një proces tejte sfidues, megjithatë të gjithë masat dhe iniciativat e ndërmarra gjatë këtyre viteve të fundit në kuadër të reformimit të Administratës Publike, me fokus digjitalizimin, e bënë ndryshimin më të lehtë për administratën publike shqiptare.



Dotë doja të nënvizoja dy nga momentet kryesore gjatë vitit 2020, të cilat konfirmuan vlerën e shtuar që procesi i digjitalizimit ka sjellë në punën e administratës, duke e transformuar atë rrënjësisht.

Shqipëria digjitale, një pikë kyçe në axhendën e qeverisë, është tashmë një realitet i prekshëm me portalin e-Albania, si pika e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare në dispozicion të qytetarëve dhe bizneseve 24/7. Një nivel i tillë i digjitalizimit të shërbimeve të institucioneve publike ka bërë të mundur uljen e kostove dhe parandalimin e rasteve të korrupsionit dhe rritjen e besimit të qytetarëve në shërbimet publike. E-Albania ishte një ndër mjetet kryesore në menaxhimin e krizës gjatë 2020, duke treguar dhe njëherë që në fakt zhvillimet teknologjike jo vetëm që lehtësojnë jetën e qytetarëve por dhe e ruajnë atë, në rastin konkret.

Gjatë 2020, patëm një tjetër arritje të rëndësishme si ajo e zhvillimit për herë të parë të një procedure rekrutimi në shërbimin civil, tërësisht online, një arritje kjo sërish e mundur nga investimet dhe iniciativat e ndërmarra gjatë viteve të fundit në drejtim të informatizimit të proceseve kyçe të administratës, duke rritur efikasitetin dhe transparencën. Ishte platforma e integruar e komunikimit administrata.al, ajo e cila për herë të parë, në Prill të 2020 mundësoi testimin elektronik duke realizuar kështu zhvillimin e procedurave të rekrutimit tërësisht online. Kjo platformë konfirmoi dhe një herë vlerën e shtuar të saj në modernizimin dhe përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike, nëpërmjet unifikimit dhe standardizimit të procedurave në nivel qendror dhe lokal.

Administrata publike, si themeli mbi të cilin implementohen të gjithë reformat e ndërmarra nga qeveria, mbetet një pikë kyçe jo vetëm për zhvillimin ekonomik e social të vendit por edhe për rrugëtimin e Shqipërisë drejt familjes evropiane. Nëpunësit tanë publikë janë faktor themelor në ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e aseteve e pasurive publike të vendit, kështu angazhimi për të patur nëpunës të kualifikuar, me integritet, të paanashëm, pjesë të strukturave efikase dhe performuese, vijon të jetë maksimal.



Modernizimet teknologjike, ndryshimet e vazhdueshme dhe veçanërisht situata aktuale e krizës, nënvizojnë gjithnjë e më shumë nevojën evidente për një administratë fleksibël, të aftë të menaxhojë dhe adresojë sfidat me të cilat përballlet dhe njëkohësisht këmbëngulëse në përpjekjet reformuese në drejtim të progresit të Shqipërisë.

Me bindjen e plotë që hapat e hedhura bashkarisht në këto vitet e fundit në reformimin e administratës publike kanë sjellë dhe do të vijojnë të sjellin rezultate të dukshme dhe transformimin e administratës tonë në një administratë inovatore, të dedikuar dhe përfaqësuese të denjë të vlerave më të mira të Shqipërisë.

Prill 2021

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

116 NËN
AKTIVITETE
në zbatim nga 130 nën
aktivitete gjithsej.



68 NËN
AKTIVITETE
të realizuara plotësisht
nga 116 që kanë nisur
zbatimin

IPSIS & KONSULTIMI PUBLIK



Baza ligjore IPSIS

Guidë
metodologjike
konsultimi publik



REKRUTIMI

Prill 2020

Procedura e parë e rekrutimit
PLOTËSISHT ONLINE

TRAJNIME



4630
nëpunës
civilë të
trajnuar

ADISA



+6 qendra
të reja

558,521
aplikime

E-ALBANIA



1021

shërbime
elektronike

144M

transaksione

1,781,674

përdorues
të regjistruar

TRANSPARENCA

Rregjistri Elektronik i
Kërkesave & Përgjigjeve

59 autoritete

PROGRESI NË ZBATIM SIPAS SHTYLLAVE



87%

POLITIKËBËRJA DHE
CILËSIA E LEGJISLACIONIT



94%

ORGANIZIMI DHE
FUNKSIONIMI I
ADMINISTRATËS PUBLIKE



89%

SHËRBIIMI CIVIL:
MENAXHIMI I BURIMEVE
NJERËZORE




90%

PROCEDURAT
ADMINISTRATIVE DHE
MBIKËQYRJA


REALIZIMI I INDIKATORËVE

12
TARGET I
ARRITUR




9*
NËN VLERËN
E SYNUAR

* nga këta: 5 indikatorë shënojnë trend në rritje, 2 trend konstant dhe 2 trend zbritës



NËN-AKTIVITETET NË ZBATIM SIPAS OBJEKTIVAVE



PRITSHMËRIA MBI ZBATIMIN E PLANIT PËR VITIN 2021



PROGRESI I STRATEGJISË



Reforma të implementuara me sukses në vitin 2020

Reforma në Administratën Publike është një proces i rëndësishëm dhe prioritar për vendin, si elementi kyç përmes të cilit qeveria Shqiptare garanton ofrimin me cilësi dhe efikasitet të shërbimeve publike për qytetarët e saj. Zhvillimi i vendit dhe zbatimi i çdo reforme të ndërmarrë mund të realizohen me sukses vetëm duke patur në themel një administratë publike të ngritur nën parimet e qeverisjes së mirë, e cila ka në rradhët e saj nëpunës të kualifikuar, të paanshëm, me integritet dhe me dedikimin për t'i shërbyer qytetarit.

Të gjitha këto parime të diktuar dhe nga vizioni i qeverisë për të përmirësuar, transformuar dhe digjitalizuar akoma dhe më tej shërbimet publike janë parashikuar nën kontekstin strategjik ku dhe mbështetet zbatimi i reformës në administratën publike.

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike (SNRAP) është baza mbi të cilën implementohet dhe monitorohet zbatimi i Reformës në Administratën Publike. SNRAP gjen mbështetje në vizionin dhe objektivat strategjike të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet (SKZHI) 2015-2020 si dokumenti themelor strategjik që kombinon axhendën e integritetit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qendrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (SDG/OZHQ).


Që në fazat e para të hartimit të SNRAP, është synuar ndërlidhja midis politikave të përcaktuara në SKZHI dhe objektivave afatgjata të cilat kanë për qëllim kryesisht përmirësimin e efektivitetit dhe efikasitetit të administratës publike dhe uljen e korrupsionit; krijimin e një sistemi

profesional, të paanshëm dhe të bazuar në merita si dhe përmirësimin e shërbimeve publike dhe të procedurave administrative dhe mbikëqyrëse.

Reformimi i Administratës Publike është një ndër elementët nën shtyllën “Themelorët: Qeverisja e mirë, demokracia dhe shteti i së drejtës” të SKZHI 2015-2020, me vizionin e zhvillimit të një administrate publike në përputhje me standartet e Administratës Evropiane me qëllimin për të ofruar shërbime me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset, në mënyrë transparente, efikase dhe të efektshme, përmes përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve novatore, në përputhje me integrimin Evropian, me anë të punonjësve civilë të paanshëm dhe profesionistë si pjesë e strukturave efikase, vizion ky dhe i SNRAP.

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, e miratuar në 15 Prill 2015 nga Qeveria Shqiptare, shërben si një dokument strategjik që orienton reformimin e administratës bazuar në katër shtylla kryesore, 11 objektiva të qarta strategjike dhe një plan veprimi i cili parashikon zbatimin e 130 nën-aktiviteteve konkrete¹.

- **Shtylla I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit (46 nën-aktivitete);**
- **Shtylla II: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike (18 nën-aktivitete);**
- **Shtylla III: Shërbimi Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (36 nën-aktivitete);**
- **Shtylla IV: Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja (30 nën-aktivitete);**



¹ Vlerësimi i zhvillimeve për vitin 2020, në pikëpamje të arritjes së objektivave të Strategjisë realizohet nëpërmjet vlerësimit të indikatorëve (treguesve të suksesit) të parashikuar në dokumentin e Strategjisë ndërkohë që vlerësimi i ecurisë së zbatimit të reformave të parashikuara në kuadër të strategjisë bazohet në vlerësimin e ecurisë së zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit.

Departamenti i Administratës Publike si institucioni përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të SNRAP, e kryen këtë proces çdo vit, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Kështu viti 2020 ishte viti në të cilin raporti i monitorimit të SNRAP, falë mbështetjes së SIGMA/OECD, erdhi me një format të përmirësuar, më të thjeshtë dhe tërheqës për publikun. Një format i cili prezantonte në mënyrë më të qartë arritjet kryesore të institucioneve publike shqiptare në kuadër të reformimit të administratës publike, dhe çka është më e rëndësishme, një paraqitje më të qartë të përfitimeve direkte që administrata dhe qytetarët kanë nga zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë.

Zbatimi dhe monitorimi i Strategjisë diskutohet në takimet e Grupit Tematik “Shërbimi Civil dhe SNRAP”, grup i udhëhequr nga DAP, i cili takimet për tematika të rëndësishme si raportimi i zbatimit të SNRAP, i zhvillon me pjesëmarrjen e partnerëve ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile. Organizimi i këtyre takimeve me pjesëmarrje të gjerë nga aktorët relevantë në Reformën e Administratës Publike, bëhet me qëllim transparencën, gjithëpërfshirjen dhe reflektimin e kontributeve të tyre në dokumentat strategjikë të vendit.


Procesi i përvitshëm i përgatitjes së raportit të monitorimit të strategjisë fillon që në fund të Dhjetorit për t’i paraprirë komponentit të rëndësishëm të analizimit dhe vlerësimit të informacionit dhe kontributeve të përcjella nga ana e institucioneve pjesë e zbatimit të SNRAP. Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të aktiviteteve të SNRAP në mënyrë progresive bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse, duke mbajtur në konsideratë Metodologjinë e SIGMA për hartimin e raporteve të monitorimit dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)”. DAP realizon komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në SNRAP, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të arritjeve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës së raportimit. Kështu gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, janë realizuar takime teknike me secilin prej institucioneve të përfshira në strategji, me qëllim evidentimin e rasteve të suksesit të cilat kanë sjellë rezultate të dukshme në punën e administratës dhe në jetën e qytetarëve e gjithashtu identifikimin e sfidave dhe problematikave të cilat kanë ndikuar negativisht në progresin apo zbatimin e aktiviteteve të parashikuara. Realizimi i procesit të identifikimit të sfidave dhe vështirësive reale dhe specifike, ka qenë një ndërmarrje jo fort e lehtë gjatë këtyre viteve, kjo për shkak dhe të kulturës së punës e cila priret më shumë të nxjerrë në pah arritjet. Megjithatë çdo vit, me ndërgjegjësimin se, në fakt identifikimi i vështirësive jo vetëm që rrit transparencën dhe qartësinë por dhe ndihmon vetë institucionet si dhe nivelet e larta drejtuese politike në marrjen e masave për kapërcimin e këtyre vështirësive, prezantimi i risqeve/sfidave/problematicave ka qenë gjithnjë e më i saktë.

Në përfundim të një procesi intensiv pothuaj tremujor, DAP harton draft raportimin e monitorimit për vitin dhe Drejtori i DAP e prezanton këtë raport para përfaqësuesve të institucioneve, partnerëve të zhvillimit dhe organizatave të shoqërisë civile. Çdo koment apo sugjerim i palëve diskutohet dhe reflektohet në raport, varianti përfundimtar i të cilit së bashku me paketën e plotë të dokumenteve, i dërgohet Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes si Sekretariati Teknik i Grupit të Integruar të Menaxhimit të Politikave “Mirëqeverisja dhe Administrimi Publik”. Në kuadër të transparencës dhe komunikimit me publikun, DAP publikon në faqen e tij zyrtare çdo [raport monitorimi](#) në gjuhën shqipe dhe angleze.


Viti 2020 ishte një vit i jashtëzakonshëm për mbarë botën, patjetër edhe për Shqipërinë. Megjithatë, institucionet publike falë hapave të ndërmarrë gjatë viteve të fundit me futjen e mekanizmave inovativë, digjitalizimit të sistemeve dhe proceseve si dhe falë aftësisë së menaxhimit të ndryshimit kanë arritur të mitigojnë deri në një farë niveli riskun dhe ndikimin e

pandemisë në zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit të SNRAP. Kështu deri në fund të 2020, pavarësisht kufizimeve evidente të shkaktuara nga situata globale dhe në vend, të dhënat tregojnë se 89% e të gjitha aktiviteteve të parashikuara në Planin e Aktiviteteve 2018-2022 kanë filluar zbatimin.


Grafiku 1 - Gjendja e zbatimit të nën-aktiviteteve në total



Plani i Veprimit 2018-2022 parashikon zbatimin e 35 aktiviteteve bazë dhe 130 nën-aktiviteteve në total. Deri në fund të vitit 2020, nga 130 nën-aktivitete në total, 116 prej tyre kanë filluar zbatimin (ose 89% e totalit)¹. Krahasimisht me vitin 2019, ku ky numër ishte 111, vihet re që situata pandemike në fakt ka ndikuar implementimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit të SNRAP, vecanërisht sa i takon fillimit të zbatimit të aktiviteteve të reja, vetëm 5 nën-aktiviteteve të reja kanë filluar zbatimin gjatë 2020. Megjithatë, nga 116 nën-aktiviteteve të cilat kanë filluar zbatimin, 68 prej tyre (59%) vlerësohen si të realizuara plotësisht duke shënuar një rritje prej 28 nën-aktivitetesh të realizuara plotësisht krahasimisht me vitin 2019, ku numri i nën-aktiviteteve të finalizuara shënonte 40. Kjo rritje e numrit të aktiviteteve të finalizuara, përpos situatës, është tregues i soliditetit të punës së bërë gjatë 2018 e 2019 në drejtim të realizimit të produkteve, e gjithashtu lidhet me masat e marra gjatë 2020 për të vijuar punën edhe në kushtet e kufizimeve. Sa i takon 14 nën-aktiviteteve të cilat nuk kanë filluar të zbatohen, 12 prej tyre duhet të kishin filluar tashmë implementimin, ndërsa dy nën-aktivitete parashikohet të fillojnë zbatimin pas gjashtëmujorit të parë të 2021.




Grafiku 2 - Gjendja e zbatimit të nën-aktiviteteve në total (%)



Grafiku 3 - Statusi i përgjithshëm i realizimit të nën-aktiviteteve (që kanë filluar zbatimin) gjatë vitit 2020

¹ Procesi i monitorimit të kryhet në nivel produkti me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra përsa i përket realizimit të produkteve dhe të aktiviteteve në përgjithësi.

Grafiku 4 - Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas Shtyllave



Siç tregojnë grafikët, numri i produkteve/nën-aktiviteteve të cilat kanë filluar zbatimin është si më poshtë:

- Nën Shtyllën I: “Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit” (40 produkte nga 46 në total);
- Nën Shtyllën II: “Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike” (17 produkte nga 18 në total);
- Nën Shtyllën III: “Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore” (32 produkte nga 36 në total).
- Nën Shtyllën IV: “Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja” (27 produkte nga 30 në total).

Megjithatë, përpos numrave, përqindjeve, produkteve dhe aktiviteteve, çka vlen të evidentohet qartë në kuadër të kësaj reforme, janë komponentët e suksesshëm, praktikat më të mira, të cilat kanë sjellë rezultate të prekshme për qytetarët. Cilat janë ndryshimet që bëjnë diferencën me momentin kohor në të cilin kjo strategji filloi të hartohej, me qëllimin adresimin e boshllëqeve dhe mangësive të identifikuara në realitetin e disa viteve më parë:

Kështu, realiteti i sotëm është një shërbim civil i reformuar, me një kornizë të mirëpërcaktuar ligjore e iniciuar me zbatimin e Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe me një sistem rekrutimi me një nivel të lartë digjitalizimi përgjatë hapave të tij. Politikat e hartuara në këto vite në drejtim të përmirësimit të procedurave të rekrutimit veçanërisht e më gjerë në proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore, kanë rezultuar në ulje të numrit të ankesave të pranura nga gjykata lidhur specifikisht me rekrutimin në shërbimin civil. Një tjetër rezultat dhe tregues i qartë i përmirësimit të sistemit të rekrutimit në shërbimin civil është dhe rritja e numrit mesatar të pjesëmarrësve në një procedurë rekrutimi duke treguar kështu një rritje të nivelit të transparencës në procedurat e rekrutimit dhe rritje të besimit të qytetarëve në administratën publike.

Një tjetër reformë e suksesshme është dhe ajo e ofrimit të shërbimeve publike. Numri i shërbimeve të ofruara nga institucionet publike sipas kriterëve të përcaktuara dhe çka është më e rëndësishme, cilësia e shërbimeve, ka ardhur gjithnjë në rritje. Falë investimeve dhe masave konkrete, zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive dhe efikase është një realitet i prekshëm i cili konkretizohet çdo ditë akoma dhe më tepër. Rritja e numrit të sistemeve të përmirësuara të IT-së, përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve si dhe shtimi i numrit të shërbimeve të ofruara tashmë online janë disa nga indikatorët të cilët tregojnë progres kundrejt synimeve.

Në një vështrim më të plotë, përkthyer në shifra, niveli i realizimit plotësisht të 59 % të nën-aktiviteteve të Planit të Veprimit 2018-2022 (të cilat kanë filluar implementimin) dhe arritjet, të reflektuara në indikatorët e rezultatit, provojnë progresin drejt vizionit strategjik.

Në mënyrë të përmbledhur viti 2020 ka shënuar disa arritje të rëndësishme në fushat kryesore të Reformës në Administratën Publike, konkretisht:

Në kuadër të përmirësimit të sistemit të politikëbërjes dhe cilësisë së legjislacionit, tashmë ka nisur procesi i përafrimit të kuadrit strategjik kombëtar me axhendën e vitit 2030. Me konsolidimin e raportit të progresit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet dhe me përfundimin e SKZHI II ka nisur puna për hartimin e SKZHI për periudhën 2020-2030 në mbështetje dhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG/OZHQ).

Janë miratuar standardet e procedurave për menaxhimin e informacionit të planifikimit strategjik². Vendimi për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të integruar padyshim i jep drejtim zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të planifikimit të politikave dhe monitorimit duke vendosur kështu standarde të reja dhe më të qarta në procesin e politikëbërjes. Ky proces është shoqëruar me hartimin e manualeve përkatëse dhe me rritjen e kapaciteteve të nëpunësve për përdorimin e **IPSIS**, të gjitha masa të ndërmarra në drejtim të rritjes së nivelit të fokusimit të planifikimit qeveritar. Iniciativat publike dhe procesi i vendimmarrjes tashmë janë në një shkallë më të lartë koordinimi falë funksionimit aktiv të mekanizmit të integruar të qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale (GMIP) në përputhje me parimet e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI).

Konsultimi publik është një ndër proceset i cili ka marrë një vëmendje të konsiderueshme vitet e fundit pasi përfshirja e shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes por dhe në ato të hartimit të legjislacionit, është komponent kyç i demokracisë pjesëmarrëse. Kështu, janë plotësuar mekanizmat ligjore dhe institucionalë që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike dhe janë hartuar metodologjia dhe udhëzimet në drejtim të përmirësimit të procesit të konsultimit, shoqëruar dhe me sesione për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike për metodologjinë dhe procesin e konsultimit publik. Çdo masë e ndërmarrë në këtë kontekst është një hap më tej në krijimin e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në jetën publike duke mbrojtur dhe lobuar për interesat e tyre legjitime. Pjesëmarrja e gjerë e publikut në këto procese kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë.

Procesi i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) i cili po zbatohet tashmë prej vitesh në vend, ka sjellë rezultate pozitive në rritjen e cilësisë dhe efektivitetin e hartimit të politikave/legjislacionit në Shqipëri duke drejtuar ndërhyrjen aty ku është e nevojshme, nëpërmjet analizave të vlerësimit të projektligjeve para miratimit të tyre. Procesi tashmë është pjesë e

² VKM nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SPI/IPSIS)".

proceseve të politikëbërjes si dhe është i shtrirë dhe në proceset legislative në Parlament. Fokus i veçantë i është kushtuar ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve pjesë e rrjetit të RIA-s. I gjithë ky proces pritet të përmirësohet akoma më tej përmes përditësimit të Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit (RIA), në përputhje me nevojat dhe zhvillimet e mëtejshme të procesit. Sa i përket zbatimit të planit analitik përmes të cilit synohet monitorimi sistematik i akteve është evidentuar një përqindje e lartë e realizimit të planit analitik dhe reflektim i lartë i akteve të miratuara nga ato të planifikuara.

Programi **[“Administrata që duam”](#)** ka vijuar zbatimin në të katërt komponentët dhe dimensionet e tij. Fokusi kryesor i aktiviteteve të parashikuara nën këtë program ka qenë orientimi, rritja e kapaciteteve, motivimi dhe bashkëveprimi të administratës, ku vëmendje kryesore i është kushtuar mirëorientimit të punonjësve gjatë kohës së pandemisë përmes përgatitjes së rregulloreve të posaçme për punën në distancë. Programi ka mundësuar rritjen e ndërveprimit përmes nxitjes dhe ndarjes së mendimeve të nëpunësve të organizuar sipas rrjeteve profesionale të ngritura, të cilat janë në funksion të plotë. Gjithashtu pjesë e këtij programi është dhe trajnimi në përmirësimin e aftësive menaxheriale, dhe paralelisht me trajnimin, është mundësuar edhe akses në paketën bazë të materialeve të trajnimit online.

Në drejtim të krijimit të **strukturave efikente** duke përmirësuar organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës publike, ka përfunduar tashmë procesi i ristrukturimit të institucioneve të varësisë në 4 sisteme ministrore (sistemet e shëndetësisë, arsimit, turizmit dhe bujqësisë). Me qëllim sigurimin e bazave të forta për mirëfunksionimin e institucioneve publike, procesi i ristrukturimit po ecën paralelisht me rishikimin e përshtatjeve të punës dhe përcaktimin e proceseve të punës si horizontale dhe vertikale për të siguruar kështu kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë sa më të plotë të strukturave e për rrjedhojë një performancë më të lartë institucionale.

Pavarësisht situatës në vend, shërbimet publike kanë vijuar të shënojnë progres të mëtejshëm me hapjen e 6 qendrave të integruara të ofrimit të shërbimeve, duke e çuar në **20** numrin total të **Qendrave të Integruara** dhe tejkaluar target-in e parashikuar në strategji. Në këto qendra qytetarët dhe bizneset asistohen për të marrë shërbimin për të cilin janë të interesuar, në më pak kohë, me më pak kosto dhe me më shumë profesionalizëm. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020, në Qendrat e Integruara **ADISA**, janë asistuar qytetarët në aplikimin nëpërmjet portalit e-Albania për mbi 1000 shërbime publike të institucioneve qendrore dhe vendore. Për t`i ardhur në ndihmë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe institucioneve shëndetësore në përballimin e situatës së Covid19, ADISA vendosi në dispozicion të stafit të Njesisë së Kujdesit Shëndetësor njësinë lëvizëse në zonën e Tiranës.

Ambicia për ofrimin e shërbimeve në **zyrat me një ndalesë** në njësitë e qeverisjes vendore ka avancuar falë mbështetjes së projektit STAR 2 ku **59 njësi të vetëqeverisjes vendore** tashmë kanë të instaluar sistemin e operimit të Zyrave me një Ndalesë.

Një arritje e rëndësishme gjatë vitit 2020 ishte zhvillimi për herë të parë i procedurave të rekrutimit në shërbimin civil plotësisht online, duke shënuar kështu përsëri një vend të parë për Shqipërinë në Ballkanin Perëndimor. Zhvillimi i procedurave të **rekrutimit online** u realizua falë një ekstensionit të platformës së integruar të komunikimit **[“administrata.al”](#)**, një platformë e cila prej tashmë dy vitesh ka transformuar mënyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore në shërbimin civil. Duhet të nënvizohet që iniciativat inovative të ndërmarra në vite nga administrata publike shqiptare në drejtim të digjitalizimit të proceseve dhe procedurave, veçanërisht ato të rekrutimit në shërbimin civil, shërbyen si një bazë solide për transformimin e rekrutimit plotësisht online.

Gjatë vitit 2020, ka vijuar puna intensive në drejtim të rishikimit të **përshkrimeve të punës** në Ministrinë e Linjës, me qëllimin primar përshkrime të qarta, të harmonizuara dhe të përmirësuara, të cilat mundësojnë ushtrimin më efikas të detyrave funksionale nga ana e nëpunësve. Paralelisht dhe në të njëjtën linjë me rishikimin e përshkrimeve të punës, ka patur progres dhe në **dizenjimin e procesve të punës** në ministrinë e linjës duke detajuar 20 procese horizontale e të njëjta dhe 5 procese vertikale specifike për çdo ministri. Dizenjimi i proceseve hap pas hapi dhe manuali i procedurave që do i përmbajë këto procese, do të jetë një element praktik në dispozicion të nëpunësve civilë për të qenë performues më të mirë, më produktivë dhe më eficientë.

E për të rregulluar gjithnjë e më tej performancën e nëpunësve civilë, tashmë ka përfunduar hartimi i manualit të **vlerësimit të rezultateve në punë** (performancës) me rekomandimet për ndryshimet ligjore të nevojshme për përmirësimin e këtij sistemi, ndryshime për të cilat ka filluar puna nga ana e DAP për t'i bërë realitet. Sigurimi i një sistemi vlerësimi performance objektiv dhe të drejtë është një kusht i domosdoshëm për motivimin e nëpunësve civilë çka sjell dhe një angazhim e dedikim më të lartë të tyre në shërbim të publikut.

Një tjetër ndër mekanizmat e rëndësishëm që synon të rrisë motivimin dhe performancën e nëpunësve civilë si dhe të bëjë më tërheqëse administratën publike për profesionistë të kualifikuar, është **reformimi i sistemit të pagave** dhe implementimi i reformës së pagave duke vënë në zbatim parimin "Pagë e njëjtë për punë të njëjtë". Projekt propozimi i letrës së politikave të pagave është drejt finalizimit dhe ka filluar puna për llogaritjen e impaktit buxhetor që reformimi i strukturës së pagave do të ketë, duke plotësuar kështu paketën e propozimit të kësaj reforme thelbësore.

Gjatë 2020, u realizua lidhja mes **Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS)** dhe sistemit të thesarit si dhe janë zhvilluar të gjithë testet e nevojshme nga [DAP](#), [AKSHI](#) dhe [MFE](#) për funksionimin dhe operimin normal të kësaj ndërlidhje e cila do t'i hapë rrugë procesit të rëndësishëm të automatizimit të pagave. Miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave për funksionimin e HRMIS dhe "administrata.al", me detyra të qarta për institucionet publike, ka qenë një zhvillim pozitiv për vendosjen para përgjegjësisë të administratës publike për zbatimin e kësaj baze ligjore në përdorimin periodik dhe të vazhdueshëm të sistemeve.

Digjitalizimi ka treguar vlerën e shtuar që sjell në rritjen e efikasitetit të administratës publike dhe në kontekstin e procedurave administrative dhe mbikëqyrjes, ku **Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil** ka zhvilluar inspektimet e përgjithshme dhe tematike në administratën shtetërore nëpërmjet mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe platformave online. Kështu, për të përmendur një ndër elementët sensitivë të zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil siç është ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, [KMSHC](#) në bashkëpunim me DAP kanë vijuar procesin e monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ministrinë e linjës dhe institucionet e varësisë të administratës shtetërore përmes platformës "administrata.al".

Një tjetër arritje e vendit në nivel rajonal ishte dhe vlerësimi me çmim i ASPA për zhvillimin e procesit **e-learning** në ceremoninë e "[Çmimeve të Administratës Publike](#)" organizuar nga ReSPA dhe OECD. Kështu gjatë 2020, [ASPA](#) ka vijuar punën për ngritjen e kapaciteteve të administratës publike duke zhvilluar 564 ditë trajnimi dhe trajnuar 4630³ nëpunës në nivel qendror e lokal dhe institucionet e pavarura. Përdorimi i platformave alternative E-learning, i diktuar nga gjendja e pandemisë, ka bërë të mundur zhvillimin e seminareve me një larmishmëri më të madhe të tematikave dhe me më shumë pjesëmarrës, veçanërisht sa i takon pjesëmarrjes nga bashkitë e vogla dhe të largëta.

Një tjetër arritje e vlerësuar me çmim në ceremoninë e “Çmimeve të Administratës Publike” organizuar nga ReSPA dhe OECD ka qenë dhe transformimi digjital i bërë në Shqipëri sa i takon ofrimin të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë. **E-Qeverisja** është sot mirëfunksionale në Shqipëri. Portali qeveritar **e-Albania** vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike online, duke ofruar mbi 1021 shërbime elektronike. Gjatë 2020 portali numëron mbi 144 milionë transaksione mes sistemeve të ndërlidhura ku 55 sisteme elektronike janë lidhur në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit duke shkëmbyer të dhëna në kohë reale dhe mundësuar më tepër shërbime elektronike tek qytetarët. Tashmë numri i përdoruesve të regjistruar në platformë është 1,781,674 (qytetarë dhe biznese).

Sa i takon vënies në zbatim të programit institucional të transparencës nga autoritetet publike, në kuadër të përdorimit të sistemeve informatike, gjatë vitit 2020 është dyfishuar numri i autoriteteve publike që kanë vënë në funksion regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve, çka lehtëson punën e [Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale](#) në kryerjen e monitorimeve për zbatimin e këtyre programeve. Ndërkohë gjatë vitit 2020 një numër total prej 239 autoritetesh publike kanë vënë në zbatim [Programin Model të Transparencës](#) duke i ofruar publikut informacione mbi institucionin, të dhëna financiare, prokurimet, shërbimet që ofrojnë etj.

Impakti i zhvillimit të sektorit në rajonin e Ballkanit Perëndimor ose më gjerë

Reforma e Administratës Publike si prioritet i qeverisë në vitet e fundit, ka dhënë frytet e saj të dukshme pasi Shqipëria është renditur vazhdimisht në krye të vendeve të rajonit sa i takon disa prej komponentëve kryesorë të reformës.

Kështu, Shqipëria është vlerësuar si lider në Ballkanin Perëndimor sa i takon Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, si nga studimet krahasuese të ReSPA ashtu dhe të SIGMA/OECD. Pikërisht nëpërmjet këtyre organizmave ndërkombëtarë, Shqipëria ka prezantuar në disa raste eksperiencën e saj para kolegëve në rajon duke shërbyer si shembull dhe praktikë e mirë. Përpos lancimit të iniciativave inovative të dedikuara për përmirësimin e procesit të rekrutimit në shërbimin civil, Shqipëria ka mirëpritur dhe delegacione nga Bosnje Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia e Veriut duke organizuar takime të dedikuara me kolegë nga Mali i Zi dhe Serbia për të prezantuar digjitalizimin e sistemit të rekrutimit dhe zhvillimin e procedurave të rekrutimit tërësisht online në kushtet e pandemisë, duke shtrirë kështu impaktin e masave të ndërmarra në vend në kuadër të reformës, në një arenë më të gjerë. Pikërisht progresi i vendit në menaxhimin e procesit të rekrutimit tërësisht online në përgjigje të situatës Covid19, ishte në fokus të [SIGMA/OECD](#) gjatë 2020 e cila në bashkëpunim me DAP, ka përgatitur dhe publikuar një paper për këtë çështje. Ky dokument është prezantuar nga DAP në një aktivitet të dedikuar ku eksperiencia e vendit është ndarë me rajonin dhe më gjerë.

Gjithashtu gjatë vitit 2020 u publikua dhe raporti [OECD “Government at a Glance: Western Balkans 2020”](#), raport i cili synon vlerësimin e politikave kombëtare dhe rajonale. Shqipëria është vlerësuar për progresin dhe hapat që po ndërmerren për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030, strategji kjo tejet e rëndësishme ku bazohet drejtimi i politikave drejt integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Shërbimet publike janë një tjetër komponent i Reformës në Administratën Publike, në të cilin arritjet e vendit, konkretisht sa i takon e-qeverisjes kanë patur rezultate dhe më gjerë, duke u vlerësuar pozitivisht në raporte ndërkombëtare. Raporti i Kombeve të Bashkuara

mbi e-Qeverisjen rendit Shqipërinë në vendin e 59-të në botë, duke ngjitur 15 pozicione në nivel botëror për treguesin e përgjithshëm të e-Qeverisjes krahasuar me vitin 2018 kur është publikuar raporti i fundit. Konkretisht, treguesi është përmirësuar nga 0.6519 pikë në vitin 2018, në 0.7399 në vitin 2020. Departamenti Amerikan i Shtetit gjithashtu ka vlerësuar pozitivisht iniciativat, investimet dhe programin e qeverisë për e-Qeverisjen dhe platformën e-Albania ku nënvizohet se kalimi i shërbimeve online përmes e-Albania rrit ndjeshëm shërbimin ndaj qytetarëve pasi shmanget kontakti fizik me zyrtarët dhe goditet korrupsioni.

Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me axhendën e Integritimit Evropian

“Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në Reformën e Administratës Publike. Është bërë një progres në zbatimin e udhëzimeve për vlerësimin e ndikimit rregullator (RIA) në ministritë e linjës, në hartimin e paketës legislative në lidhje me planifikimin e politikave, në rritjen e numrit të shërbimeve elektronike dhe përmirësimin e transparencës në mbledhjen e të dhënave dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në nivel qendror dhe lokal”. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet të:

- vijojë ngritjen e kapaciteteve në ministritë e linjës për të implementuar në mënyrë efektive vlerësimin e ndikimit rregullator dhe buxhetor jo vetëm për propozimet ligjore por për të gjitha propozimet e politikave;
- të zhvillojë më tej kuadrin rregullator të planifikimit dhe monitorimit të politikave dhe të vërë në funksionim sistemin e integruar të politikëbërjes;
- të përparojë përgatitjet për implementimin e politikës së pagave për nëpunësit civilë dhe të lidhë sistemin informatik të menaxhimit të burimeve njerëzore me thesarin, për të mundësuar automatizimin e pagave.

****Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë më 6 Tetor 2020***

Reforma në administratën publike vijon të mbetet një prioritet i qeverisë shqiptare jo vetëm si një nga parakushtet për aderimin në Bashkimin Evropian por edhe si një reformë ndërsektoriale me ndikim në çdo proces reformues të ndërmarrë në vend. Administrata Publike është baza dhe faktori kyç i implementimit të suksesshëm të çdo mase apo iniciative të ndërmarrë nga qeveria në funksion të zhvillimit të vendit.

Duke konsideruar rëndësinë e kësaj reforme dhe prioritetin e saj në kuadër të integritimit evropian, me qëllim sigurimin e një kornize afatmesme për një dialog më të strukturuar mbi administratën publike duke përfshirë qeverisjen lokale, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), është krijuar Grupi i Posaçëm për Reformën e Administratës Publike BE- Shqipëri (PAR SG). Ky Grup i Posaçëm shërben si platforma kryesore për të çuar përpara punën në kuadër të Reformës në Administratën Publike dhe ka për synim përfshirjen e kësaj reforme në procesin e zgjerimit. Me një periodicitet një vjeçar, përfaqësues të institucioneve shqiptare të përfshira në zbatimin e reformës në administratën publike, dhe zyrtarë të Komisionit Evropian diskutojnë mbi progresin e vendit në kuadër të kësaj reforme dhe nxjerrin konkluzione për periudhën pasardhëse. Në kuadër të transparencës të reformës në administratën publike dhe vlerësimeve të strukturave të Bashkimit Evropian, me zyrtarizmin e tyre, konkluzionet operationale të Grupit të Posaçëm publikohen në faqen zyrtare të [DAP](#).

Vlen të përmendet që pikërisht për shkak të natyrës së saj gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale, Reforma në Administratën Publike është një ndër më sfidueset, megjithatë në krahasim me prioritetet e tjera është ajo që vazhdimisht ka marrë vlerësimin më të lartë për progresin e bërë.

Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit

Viti 2020 ishte një vit i pazakontë për shkak të situatës së Covid19 në vend çka ka ndikuar drejtëpërdrejt në realizimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2018-2022 të SNRAP, veçanërisht në aktivitetet të cilat realizohen në baza vjetore. Ky konstatim është bërë bazuar në ecurinë e dokumentuar dhe treguesit apo afatet e parashikuara në Planin e Veprimit 2018-2022 të SNRAP (Aneks I). Procesi i monitorimit të vazhdueshëm që kryhet nga DAP ndihmon në identifikimin e problematikave apo ngërçeve në realizimin e aktiviteteve të parashikuara, me qëllim adresimin e tyre në mënyrën dhe kohën e duhur. Raportimi eksplicit i këtyre problematikave, ndihmon në rritjen e vëmendjes ndaj komponentëve që kanë nevojë për përpjekjet të shtuara për të përmirësuar implementimin e më tej realizimin final.

Kështu, bazuar në analizimin e kontributeve dhe raportimeve të institucioneve të përfshira në zbatimin e SNRAP, elementët të cilët kanë nevojë për adresim dhe vëmendje të shtuar janë paraqitur më poshtë sëbashku me propozimet për zgjidhje:

Funksionimi i plotë dhe i vazhdueshëm i IPSIS, duke siguruar monitorimin e dokumentave kryesorë strategjikë të vendit në mënyrë më efikente dhe të koordinuar e duke shmangur mbivendosje

Të adoptohet baza ligjore e nevojshme për metodologjinë e re dhe t' i kushtohet vëmendje e shtuar ndërgjegjësimit të institucioneve për përdorimin e sistemit si dhe trajnimit të vazhdueshëm të nëpunësve civilë të përfshirë në proces.

Rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e procesit të konsultimit publik dhe komunikimi i vazhdueshëm me shoqërinë civile për të nxitur marrjen e kontributeve/mendimeve prej tyre për politika, ligje dhe strategji të hartuara nga institucionet publike

Adoptimi i guidave dhe manualeve në drejtim të përmirësimit të procesit të konsultimit publik dhe rritja e kapaciteteve të nëpunësve të cilët realizojnë këtë proces.

Rritja e mëtejshme e kapaciteteve të nëpunësve lidhur me Vlerësimin e Ndikimit Rregullator dhe buxhetor për të gjithë politikat

Zhvillimi i trajnimeve dhe trajnimeve të trajnerëve për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme sa i takon zbatimin të RIA.

Rritja e kapaciteteve të nëpunësve të nivelit lokal për zbatimin rigoroz të legjislacionit të shërbimit civil

Trajnimi i vazhdueshëm i nëpunësve në nivel qendror dhe lokal mbi përdorimin e platformës "Administrata.al" si dhe ndërgjegjësimi mbi lehtësitë që sjell përdorimi i platformës në unifikimin dhe zbatimin e procedurave në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Përdorimi dhe raportimi i vazhdueshëm nga ana e institucioneve në Regjistrin Qendror të Personelit (HRMIS) dhe platformën e bashkëpunimit "administrata.al" sipas parashikimeve të aktit nënligjor që rregullon përdorimin e tyre	Ngritja e kapaciteteve të nëpunësve në përdorimin e sistemeve të cilat përmirësojnë, standardizojnë dhe unifikojnë proceset kryesore të menaxhimit të burimeve njerëzore.
Vijimi i ngritjes së kapaciteteve institucionale në fushën e integritetit evropian si në nivel qendror dhe në atë lokal	Planifikimi i trajnimeve në fushën e integritetit evropian nga ana e ASPA dhe për vitin 2021 sidomos për nëpunësit në nivel lokal.
Konsolidimi i programit të trajnimit të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues	ASPA duhet të marrë masat e nevojshme që të reflektohen në këtë program propozimet/rekomandimet në vijim të fazës së pilotimit dhe të procedohet me konsolidimin e tij.
Ofrimi i shërbimeve elektronike të shtuara nëpërmjet platformës e-Albania	AKSHI në këtë drejtim duhet të sigurojë infrastrukturën e nevojshme teknologjike për kalimin e të gjitha shërbimeve online.
Miratimi i dokumentit të politikave të pagave dhe zbatimi i reformës së pagave	Hartimi dhe ekzekutimi i planit të punës për fazat dhe hapat konkretë drejt finalizimit dhe miratimit të dokumentit të politikës së pagave.
Shtimi i institucioneve të përfshira në Regjistrin Elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve	Monitorimi periodik i autoriteteve publike mbi vënien në zbatim të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve dhe monitorimi përmes instrumentave të rinj të krijuara mbi matjen e indeksit të Transparencës Proaktive në nivel lokal dhe qendror.

Kryesisht, puna e institucioneve të përfshira në zbatimin e strategjisë duhet të fokusohet në zbatimin e masave sipas afateve të përcaktuara dhe në funksion të realizimit të produkteve dhe rezultateve të parashikuara.

Në terma konkretë, sa i takon numrit të nën-aktiviteteve të përfshira dhe afateve të tyre për tu finalizuar, nga 14 nën-aktivitete për të cilat nuk ka filluar implementimi, 3 prej tyre janë përtej afatit të parashikuar të realizimit çka do të duhet të adresohet me prioritet gjatë 2021. Gjithashtu nga totali i 48 nën-aktiviteteve të cilët janë aktualisht në zbatim e sipër, 18 prej tyre janë përtej afatit të parashikuar në Planin e Veprimit, kjo e ndodhur kryesisht për shkak të situatave të vështira në të cilat kaloi vendi me tërmetin e vitit 2019 dhe situatën pandemike që pasoi.


Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit të strategjisë

Monitorimi i zbatimit të buxhetit të planit të veprimit të SNRAP është një element i rëndësishëm që mundëson analizimin e efikasitetit dhe efektivitetit të progresit të strategjisë në nivel produkti. Ky monitorim siguron transparencë për publikun e gjerë dhe palët e interesuara dhe prezanton një pamje realiste të shpenzimeve të kryera me qëllim marrjen e masave për të adresuar nevojat sa i përket burimeve financiare. Paraqitja e shpenzimeve të kryera shërben gjithashtu në përgatitjen dhe argumentimin e duhur të politikave prioritare të cilat gjejnë mbështetje në programin buxhetor afatmesëm dhe të cilat lidhen drejtpërdrejt me strategjinë.

Plani i Veprimit 2018-2022 i kostuar parashikon që kosto totale e zbatimit të aktiviteteve është 1,972,158 mijë ALL, nga të cilat 944,391 mijë ALL mbulohen nga buxheti i shtetit, 875,535 mijë ALL nga donatorët dhe hendeuku financiar është 152,232 mijë ALL.

Me vënien në funksionim të IPSIS (sipas parashikimeve në vendimin e miratuar në Prill të 2020) dhe ndërlidhjen e masave nga AFMIS dhe IPSIS, do të gjenerohet një panoramë e plotë e shpenzimeve për totalin e planit të veprimit por edhe për çdo qëllim politik. Kjo si për pjesën e masave të mbuluara nga buxheti i shtetit dhe për ato masa të mbuluara nga mbështetja e partnerëve të zhvillimit. Kështu, në mungesë të një informacioni të plotë që në të ardhmen do të mund të gjenerohet nga IPSIS, me mekanizmat dhe informacionin në dispozicion, është bërë një analizë e shpenzimeve faktike të deritanishme për realizmin e nën-aktiviteteve të SNRAP.

Në këtë fazë pasqyrimi i burimeve financiare të shpenzuara ka qenë i mundur vetëm në ato raste dhe për ato objektiva që kanë në përbërje masa të cilat tashmë kanë përfunduar dhe janë mbuluar kryesisht nga ndihma e huaj. Ky është rasti i masave të mbuluara në kuadër të projektit IPS2 për objektivin 1, 2, dhe 3 nën shtyllën e parë "Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit", ku në total nga 34 masa nën udhëheqjen e Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, 32 masa janë mbuluar me buxhet në vlerën 2,818,155 Euro (tipologjia: grante/ asistencë teknike dhe investime) nga ku 97% rezultojnë të mbuluara dhe të disbursuara. Ndërkohë ka një hendeq financiar në objektivin 1 i cili është adresuar në IPA 2020. Gjithashtu një informacion mbi shpenzimet buxhetore është referuar dhe për masat nën objektivin 5 dhe 8 ku është shpenzuar:



Nga analiza që DAP ka bërë bazuar në Planin e Aktiviteteve 2018-2022 të kostuar, vëmendja duhet të përqendrohet në drejtim të objektivave me hendeq financiar. Në vlerë totale hendequ financiar është 152,232 mijë ALL (1,171,012 euro) ose 8% e [kostos totale të parashikuar të zbatimit të aktiviteteve të SNRAP](#). Megjithatë vlen të përmendet që disa prej nën-aktiviteteve të parashikuara janë realizuar dhe do të realizohen nëpërmjet punës së institucioneve të përfshira në zbatimin e strategjisë si detyra shtesë funksionale të nëpunësve publikë çka nuk përkthehet në kosto shtesë faktike apo nevojë të mëtejshme për mbulim apo financim.

Shtylla I – Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit

Politikat nën këtë shtyllë synojnë forcimin e sistemit të planifikimit strategjik, monitorimit të politikave dhe legjislacionit, raportimit dhe vlerësimit, që i shndërron prioritetet e qeverisë në veprime konkrete. Përmes ngritjes së sistemeve të informacionit për planifikimin e politikave dhe financave publike synohet përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit midis ministrive, rritja e transparencës për dokumentet strategjike të qeverisë dhe monitorimi në kohë reale.

Objektivat e planifikuara në kuadër të Shtyllës I synojnë:



Politikat planifikuese dhe koordinuese të përmirësuara për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete




Sistem transparent i hartimit të ligjeve, gjithëpërfshirës, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis




Ndërtimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimiefikastëstrategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: 1) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjans dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit, si dhe 2) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi

Shtylla 1 “Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit” parashikon realizimin e 46 nën-aktiviteteve, nga të cilat kanë filluar të zbatohen 40 nën-aktivitete (87%) e prej këtyre të fundit janë realizuar plotësisht 33 nën-aktivitete ose 83%.


Grafiku 5 - Progresi për qëllimin politik:
Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit




Grafiku 6 - Statusi i realizimit të qëllimit
Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit



Grafiku 7 - Numri i produkteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 8 - Statusi i realizimit të produkteve sipas Objektivave



Shqipëria tashmë ka iniciuar procesin e përafrimit të kuadrit strategjik të vendit me Axhendën 2030, proces ky i cili pati një zhvillim domethënës gjatë vitit 2020 me konsolidimin e Raportit të Progresit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI II). Raporti nënvizon angazhimin e plotë të Shqipërisë për të zbatuar Axhendën 2030 dhe progresin e rëndësishëm në përafrimin e SKZHI II dhe lidhjen e strategjive sektoriale me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), duke mbështetur vendin për të ndërtuar vizionin 2030. Viti 2020 shënoi përfundimin e SKZHI II dhe me përmbylljen e procesit të monitorimit të saj, qeveria Shqiptare do të vijojë me fazën e vizionimit dhe hartimit të bazës për SKZHI-në e ardhshme 2020-2030. Ky dokument i rëndësishëm strategjik do të paraqesë përparësitë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, do të orientojë politikat drejt integritimit në BE dhe do të sigurojë përmbushjen e Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030.

Zbatimi i reformave të ndërmarra, përmbushja e prioritetëve të vendit dhe adresimi i çështjeve të integritimit evropian janë procese të cilat tashmë gëzojnë një qëndrueshmëri më të madhe falë funksionimit të rregullt të mekanizmit të qasjes së integruar sektoriale¹. Kjo falë dhe rolit aktiv dhe dinamik të forumeve të nivelit të lartë të dialogut dhe politikëbërjes si GMIP/KDS çka ka sjellë një unifikim të mëtijshëm të qasjes.

Planifikimi dhe monitorimi i politikave dhe strategjive ka tashmë standarde dhe procedura të miratuara për menaxhimin e informacionit të planifikimit strategjik. Kështu procesi i planifikimit qeveritar do të jetë tashmë më i fokusuar, me realizimin e tij nëpërmjet sistemit IPSIS. Ndër të tjera sistemi krijon të gjithë procedurat e nevojshme për tu implementuar në kuadër të procesit të Integritimit Evropian të vendit, çka merr akoma më shumë vlerë në momentin kyç në të cilin ndodhet Shqipëria sa i takon proceseve integruese.



Vlera 2020

60 %

INDIKATORI 1A

100% E KUADRIT STRATEGJIK RREGULLATOR I HARTUAR DHE I ZBATUAR

Krahasuar me vitin 2019, ku vlera e **indiktorit 1a**, i cili tregon aftësinë planifikuese të dokumentave strategjikë bazuar në Programin Analitik Vjetor të Projekt-akteve ishte 52%, gjatë vitit 2020, kjo vlerë rezulton të jetë rritur në nivelin 60 %. Rritja e aftësisë planifikuese të institucioneve publike shqiptare vjen si rezultat i proceseve të dedikuara për rritjen e kapaciteteve të nëpunësve publike të angazhuar në proceset e politikëbërjes. Megjithatë mosarritja e target-it prej 100%, si dhe një krahasim dhe me vitin 2018 (vlera ishte 80%) tregon nevojën për një përmirësim të mëtijshëm të këtyre kapaciteteve nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit lidhur me rëndësinë e procesit, apo dhe trajnimeve të dedikuara për këtë qëllim².



Vlera 2020

88.57%

INDIKATORI 1B

"100% E STRATEGJIVE DHE E CILËSISË SEKTORIALE E PËRFUNDUAR" (ME LLOGARITJEN E KOSTOS SË PLANIT TË VEPRI-MIT DHE GRUPIN E INDIKATORËVE ME OBJEKTIVAT PËRKATËS)

Indikatori 1b "100% e strategjive dhe e cilësisë sektoriale e përfunduar" ka shënuar një rritje në 88.57% për vitin 2020. Nga lista e 25 dokumenteve strategjikë të aprovuara për vitin 2020, rezultati mesatar i cilësisë shënon një trend përmirësues për kuadrin strategjik krahasuar me vitin 2019 (vlera e këtij indikatori për vitin 2019 ishte 77.42%; për 2018 ishte 82%)³.

¹ Gjatë 2020 mekanizmi ka organizuar në mënyrë të strukturuar/planifikuar (31%) më shumë takime krahasuar me vitin 2019.

² Target: 100%. Indikatori nuk është arritur edhe pse ka trend në rritje.

³ Target: 100%. Indikatori nuk është arritur edhe pse ka trend në rritje.

Rol të rëndësishëm në përmirësimin e koordinimit të politikave dhe atij të vendimmarrjes ka luajtur dhe funksionimi aktiv i mekanizmit të integruar të qasjes ndërsektoriale në përputhje me parimet e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), sistem i cili siguron diskutim të politikave, performancës dhe një shpërndarje efektive të burimeve financiare. Kjo rritje e nivelit dhe përmirësimi i rezultatit mesatar të cilësisë së kuadrit strategjik lidhet me masat e ndërmarra gjatë vitit 2020 nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes dhe ministritë e linjës në zbatimin e standardeve dhe procedurave të përcaktuara për menaxhimin e informacionit të planifikimit strategjik.

Vendimi i Këshillit të Ministrave i aprovuar për funksionalitetin e IPSIS

Miraturuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)

Metodologji e hartuar për përgatitjen e dokumentave strategjike

Përgatitur manualët strukturore të sistemit si dhe është përgatitur draft-ligji për planifikimin strategjik i asistuar nga një ekspertizë e dedikuar përmes fondeve të IPS TF II

Kapacitete të ngritura për përdorimin e IPSIS.


400 nëpunës të trajnuar dhe të njohur me praktikën dhe procedurat e sistemit

IPSIS në funksion të plotë/ Go-Live

IPSIS, është aprovuar nga Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit si autoriteti menaxhues i certifikatës së sistemit që lancon operacionalizimin dhe funksionalizimin e plotë të sistemit.

Hartuar dhe konsoliduar manualët e sistemit IPSIS në dy gjuhë.

Guidat specifike metodologjike lidhur me modulën e monitorimit dhe hartimit të kuadrit strategjik. u janë shpërndarë përdoruesve të sistemit dhe kanë qënë baza kryesore e kurrikulës për trajnimet specifike lidhur me modulet respektive të sistemit



Vlera 2020

86 %

INDIKATORI 1C

70% E STAFIT TË POLITIKËBËRJES TË ML-SË I TRAJNUAR TË PAK-TËN NJË HERË PËR ÇËSHTJET E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Një ndër arsyt kryesore të përmirësimit të arritjes së indikatorëve është dhe ngritja dhe forcimi i kapaciteteve për planifikimin strategjik në ministritë e linjës (**Indikatori 1c**), një indikator i cili është pothuajse dyfishuar në krahasim me vitin 2019 (vlera e këtij indikator për vitin 2019 ishte 43% dhe për vitin 2018 ishte 29.57%)⁴. Gjatë vitit 2020, rreth 400 nëpunës të njohur tashmë me praktikën dhe procedurat e sistemit IPSIS kanë marrë pjesë në trajnime me qëllim rritjen e cilësisë së politikëbërjes dhe respektimin e parimeve të planifikimit të integruar, përdorimin më të mirë të burimeve, rritjes së performancës dhe llogaridhënies.

⁴ Target: Më shumë se 70 % e stafit janë trajnuar. Indikatori është arritur.

Procesi i Konsultimit Publik është një nga komponentët kryesorë me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës si një nga objektivat madhorë të sistemit të mirëqeverisjes. Ky proces si dhe përfshirja e rregullave të vlerësimit të ndikimit janë elementë të rëndësishme në proceset e politikëbërjes në Shqipëri⁵. Tashmë procesi i konsultimit publik është përmirësuar falë mbështetjes së projektit “Asistenca Teknike për përmirësimin e kornizës rregullatore dhe konsultimit publik” të financuar nga Bashkimi Evropian, duke përcaktuar standardet e konsultimit publik dhe prezantimin e modeleve të reja për planifikimin dhe raportimin e rezultateve të konsultimeve publike. Paralelisht me progresin në këtë drejtim është synuar forcimi i kulturës së pjesëmarrjes në procesin e konsultimit publik duke promovuar pjesëmarrjen civile në mënyrë sistematike dhe ngritjen e mekanizmave për procesin e konsultimit publik. Ky proces tashmë është përmirësuar akoma më tej duke u bërë pjesë integrale e IPSIS, sistem përmes të cilit u mundësohet koordinatorëve të përgatisin raporte të konsultimit publik brenda modulit të dedikuar dhe të veçantë. Megjithatë duhet të merren masa të mëtejshme për të realizuar një proces sa më të hapur dhe transparent, sa i takon angazhimit të publikut por edhe reflektimit të komenteve të marra gjatë procesit.

Masat e finalizuara në kuadër të përmirësimit të procesit të konsultimit publik



Ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e konsultimit publik ka vijuar dhe gjatë vitit 2020 ku janë trajnuar 159 nëpunës civilë të administratës publike mbi metodologjinë dhe procesin e konsultimit publik si dhe janë organizuar 13 workshope/seminare trajnimi me fokus rritjen e kapaciteteve dhe ekspertizës të Koordinatorëve të Konsultimit Publik.

Sa i takon zbatimit të procesit të vlerësimit të ndikimit është shënuar një progres i dukshëm në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në hartimin e politikave/legjislacionit në Shqipëri duke bërë të mundur që ndërhyrja e qeverisë të drejtohet aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate më të mira me një kosto minimale administrative nëpërmjet analizave ex-ante të vlerësimit të politikave/akteve ligjore, para miratimit të tyre. Gjatë vitit 2020 numri i raporteve të vlerësimit të ndikimit, të miratuara nga Njësia e Programit të Akteve është rritur në 44.

Me qëllim forcimin e kapaciteteve brenda ministrive, përgjatë vitit 2020 janë trajnuar një numër më i madh nëpunësish civilë (80 nëpunës), përveç atyre që janë pjesë e Rrjetit të përhershëm të RIA-s, me qëllim përvetësimin sa më mirë të metodologjisë së vlerësimit të ndikimit dhe mënyrën e hartimit të raporteve RIA.

Në lidhje me monitorimin sistematik të zbatimit të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2020, Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në

Kryeministri, e cila është përgjegjëse për këtë proces, ka vijuar me monitorimin e zbatimit të PPAP për vitin 2020 dhe ka hartuar raporte periodike javore, mujore si dhe raportin vjetor për periudhën Janar – Dhjetor 2020. Në kuadër të këtyre raportimeve është konstatuar se përqindja totale e realizimit të Planit Analitik 2020 është 69% dhe kjo shifër konstatohet të jetë jo vetëm përqindja më e lartë e realizimit të Planit Analitik në periudhën 2013-2020 por edhe reflektim i numrit më të lartë të akteve të miratuara nga ato të planifikuara (289).

Sa i përket monitorimit të vazhdueshëm të botimit të akteve ligjore të konsoliduara, me qëllim rritjen e transparencës në botimin e legjislacionit, në faqet e internetit të institucioneve rezulton se edhe gjatë 2020 nuk janë botuar në faqet zyrtare të tyre versionet e konsoliduara të akteve ligjore. Ndërkohë Qendra e Botimeve Zyrtare (QBZ), për vitin 2020, ka publikuar të gjitha versionet e konsoliduara të akteve ligjore të botuara përgjatë këtij viti.



Vlera 2020

72%

INDIKATORI 2A

CILËSIA E ANALIZËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË AKTEVE LIGJORE TË RËNDËSISHME TË HARTUARA DHE TË PUBLIKUARA

Viti 2020 është viti i dytë i matjes të **indiktorit 2a**. Për 2020 indikatori shënon vlerën 72%, një rritje krahasimisht me nivelin 64% në vitin 2019⁶. Forcimi i kapaciteteve të nëpunësve që janë pjesë e rrjetit të përhershëm të RIA ka ndikuar në përvetësimin më të mirë nga ana e tyre të procesit të vlerësimit në ndikim të akteve dhe gjithashtu ka përmirësuar cilësinë në përgatitje.



Vlera 2020

79.56%

INDIKATORI 2B

PËRQINDJA E AKTEVE LIGJORE TË CILAT KANË KALUAR PËRMES NJË PROCESI TË GJERË KONSULTIMESH PUBLIKE DHE PROVAT E PËRFSHIRJES SË PUBLIKUT DHE PALËVE TË INTERESUARA NË PROCES

Indikatori 2b mbi aktet ligjore të cilat kanë kaluar përmes një procesi të gjerë konsultimesh publike, ka shënuar një rritje në krahasim me një vit më parë, duke shënuar vlerën 79.56% krahasimisht me vitin 2019 ku shënonte vlerën 71.4% (vlera për vitin 2018 ishte 47.22%)⁷. Një trend në rritje ka shënuar dhe indikatori i cilësisë së konsultimit publik i cili vlerësohet në nivelin 5.66 pikë për vitin 2020, krahasimisht me vitin 2019 ku shënonte vlerën 5.56 pikë. Për vitin 2020 ka një tendencë në rritje krahasuar me vitin 2019 të akteve të konsultuara në zbatim të ligjit për konsultimin publik, çka ka rritur dhe diskutimet me grupet e interesit dhe ka krijuar një dinamizëm në kuadër të ligjbërjes dhe politikëbërjes, pavarësisht rrethanave të vështira të 2020. Krahasuar me vitin 2019 ka një rritje të tendencës të konsultimeve të akteve në Regjistrin Elektronik (viti 2020 - 60% kundrejt vitit 2019 - 40%). Guida metodologjike e hartuar për procesin e konsultimit publik dhe trajnimet në këtë fushë kanë rritur kapacitetet institucionale në këtë drejtim dhe si rrjedhojë është përmirësuar procesi i konsultimit dhe është rritur dhe përqindja e akteve ligjore të cilat kalojnë përmes procesit të konsultimit publik. Megjithatë synimi prej 100% është akoma i paarritur, pra nevojiten përpjekje të shtuara në realizimin e këtij procesi në mënyrë sa më transparente dhe efektive.



Vlera 2020

1

INDIKATORI 2C

NUMRI I AKTEVE LIGJORE TË NDRYSHUARA BRENDA VITIT TË PARË TË MIRATIMIT

⁶ Target: tendencë në rritje. Indikatori është arritur.

⁷ Target: 100%. Indikatori nuk është arritur edhe pse ka trend në rritje

Indikatori 2c monitoron ndryshimet ligjore brenda harkut kohor të 12 muajve nga miratimi i projektligjit bazë apo i ndryshimeve më të fundit të tij. Nga procesi i monitorimit për vitin 2020, rezulton se nga 98 projekt-akte të cilat janë miratuar në vitin 2020, 14 prej tyre janë amenduar brenda harkut kohor të 12 muajve nga miratimi i vetë akteve ligjore apo i ndryshimit më të fundit të tij. Por nëse marrim në konsideratë faktin që 13 prej tyre lidhen me çështjet e menaxhimit të situatës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, mund të konkludojmë se vetëm një projekt akt ka pësuar ndryshim. Fakti që ky indikator vijon të jetë në nivele të ulta tregon qëndrueshmëri, cilësi dhe planifikim më të mirë të legjislacionit të hartuar brenda një viti (vlera e indikatorit për vitin 2019: 2 akte, ndërsa për vitin 2018: 9 akte)⁸.

Lidhur me përputhshmërinë e raporteve të hartuara në vitin 2020 me standardet IPSIS në përputhje me bazën ligjore që rregullon këtë proces, janë hartuar manualët dhe protokollet e sistemit si dhe janë zhvilluar trajnime të dedikuara për modulën e monitorimit dhe raportimit të kuadrit strategjik. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2020 ministrinë kanë filluar përshtatjen me modulet e kuadrit strategjik dhe modulet e raporteve të monitorimit⁹. Në bazë të të dhënave për vitin 2020 rezulton se 28% e raporteve kanë përputhshmëri të pjesshme dhe rreth 68% kanë nevojë të adoptojnë të dhënat gjatë periudhës në vijim.



Vlera 2020

53.75%

INDIKATORI 3A

PËRQINDJA E RAPORTEVE TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT PËR STRATEGJITË E RËNDËSISHME TË HARTUARA DHE TË PUBLIKUARA NË BAZA VJETORE.

Indikatori 3a i lidhur me publikimin e raporteve të monitorimit ka shënuar rritje krahasimisht me vitin 2019 ku niveli i publikimit të raporteve të hartuara ka qenë 13.7% (vlera e indikatorit për vitin 2019: 13.7%; për vitin 2018: 90.9%)¹⁰. Kjo rritje lidhet me masat e marra në kuadër të zbatimit të qasjes së gjerë sektoriale dhe ndërsektoriale për të rritur transparencën gjatë procesit të politikëbërjes ku rol kryesor luan dhe funksionimi i mekanizmit të integruar të politikave. Përmes këtij mekanizmi shpërndahen raportet e monitorimit¹¹ të hartuara nga çdo sektor. Treguesit e performancës së mekanizmit janë në rritje duke shënuar 232 takime të zhvilluara gjatë 2020 krahasimisht me 151 takime të zhvilluara në 2019 dhe 42 në 2018.



Vlera 2020

29

INDIKATORI 3C

NUMRI I KONSULTIMEVE PUBLIKE/PREZANTIMEVE TË ORGANIZUARA PËR TË DISKUTUAR RAPORTET E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT.

Indikatori 3c për vitin 2020 shënon 29 konsultime publike, një numër ky më i lartë se vlera e shënuar në vitin 2019 (vlera e indikatorit për vitin 2019: 10, ndërsa për vitin 2018: 11)¹². Dinamika e raportimit dhe transparencës për vitin 2020 është rritur në vlerën 32% dhe volumin më të madh e zë sektori i mirëqeverisjes ku të gjitha raportet e monitorimit diskutohen në Grupet përkatëse të Menaxhimit të Integruar të Politikave.

⁸ Target: tendencë në ulje. Indikatori është arritur.

⁹ Pavarësisht se viti 2021-2020 parashtrihet si një vit tranzitor dhe përbën një fazë të ndërmjetme sa i takon zbatimit të sistemit dhe protokolleve që do të duhet të ndiqen.

¹⁰ Target: tendencë në rritje. Indikatori është arritur.

¹¹ Indikatori 3b "Shkalla në të cilën raportimi jep informacion mbi rezultatet e arritura (indikator i SIGMA-s)" shënon vlerën 3 në matjen e tij më të fundit, realizuar nga SIGMA në 2017. Linku i SIGMA për të aksesuar raportet e tyre të vlerësimit për vendin: <http://www.sigmaweb.org/publications/>

¹² Target: tendencë në rritje. Indikatori është arritur.

Programi “Administrata që duam”, si një iniciativë e qeverisë shqiptare për energjizimin e administratës publike ka vijuar zbatimin në drejtim të orientimit, aftësisht, motivimit dhe ndërveprimit të nëpunësve publikë me qëllim sigurimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.

Aktivitetet e parashikuara në zbatim të programit janë fokusuar përgjatë vitit 2020 në rritjen e ndërgjegjësisht dhe orientimit të administratës. Departamenti i Administratës Publike ka vijuar me qasjen proaktive në rrjetet sociale për të mirëorientuar jo vetëm punonjësit e administratës publike por edhe kandidatët e mundshëm të cilët duan të bëhen pjesë e shërbimit civil. Në këtë kuptim, përdorimi i rrjeteve sociale ka pësuar një rritje nga viti në vit, me një qasje user-friendly duke përfshirë postimet si: aktivitete të ndryshme, fushata informuese, informacione rreth procedurave kyçe që kryen institucioni. Me qëllim mirëorientimit e punonjësve të administratës si dhe publikun e gjerë, çdo muaj publikohen në faqen zyrtare (www.dap.gov.al), faqen e platformës së integruar të komunikimit dhe raportimit të përbashkët për të gjithë administratën publike “administrata.al” dhe në rrjetet sociale të institucionit informacione orientuese, lajme dhe buletini mujor ku prezantohen aktivitetet më të rëndësishme.

Një kontribut i veçantë për administratën shqiptare përgjatë vitit 2020 ishte dhe përgatitja e rregullores së posaçme për punën nga distanca, kombinuar me punën nga zyra, për shkak të pandemisë. Rregullorja garantoj vijimësinë e punës për institucionet e administratës shtetërore si dhe krijoi kushte të përshtatshme për vijimin e veprimtarisë së tyre nëpërmjet kombinimit të punës në ambientet e institucionit dhe telepunës (puna në distancë). Duhet nënvizuar se krijimi i kulturës së punës nga shtëpia ishte një proces jo i lehtë pasi edhe përdorimi i teknologjisë moderne ishte sfidues për punonjësit e administratës për raportimet, takimet dhe mbledhjet virtuale.



Programi “Administrata që Duam” tashmë ka mundur rritjen e ndërveprimit të administratës duke shkëmbyer mendimet dhe eksperiencat ndërmjet zyrtarëve të së njëjtës fushë dhe përmirësuar aftësitë e tyre për të kryer funksionet dhe detyrat ditore. Në zbatim të akteve nënligjore¹³ që normojnë bashkëpunimin institucional janë funksionale 7 rrjeteve profesionale në fushat kryesore¹⁴. Një mjet tejet i rëndësishëm për rritjen e ndërveprimit të administratës publike gjatë vitit 2020 ishte dhe përdorimi i platformës “administrata.al”, përmes të cilës ndër të tjera është përmirësuar ndërveprimi midis institucioneve publike dhe është lehtësuar komunikimi dhe raportimi i informacionit në kohë reale si dhe përmirësimi i cilësisë së punës në drejtim të mirëmenaxhimit të burimeve njerëzore.

Në drejtim të rritjes së motivimit të administratës është finalizuar manuali për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë i cili shërben për të udhëzuar zyrtarët vlerësues në institucionet e administratës shtetërore dhe për të siguruar një proces sa më objektiv të nëpunësve civilë. Departamenti i Administratës Publike do të vijojë me përmirësimet apo ndryshimet e nevojshme të propozuara në bazën ligjore për sistemin e vlerësimit të rezultateve në punë. Kështu, për të vënë në zbatim rekomandimet për përmirësimin e sistemit të vlerësimit të rezultateve në punë është propozuar të ndryshohet: (i) ligji nr. 152/2013, për efekt të ndryshimit të shkallëve të vlerësimit; (ii) VKM nr. 109/2014, e ndryshuar; si dhe të hartohet një udhëzim shpjegues i Departamentit të Administratës Publike për procesin e vlerësimit të rezultateve në punë.

¹³ VKM nr. 867 datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”.

¹⁴ Rrjeti i Sekretarëve të Përgjithshëm, rrjeti i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA), rrjeti i Politikave dhe Programeve të Zhvillimit, rrjeti i Programit Buxhetor Afatmesëm, rrjeti i Prokurimeve, rrjeti i Integritetit dhe rrjeti i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Shtylla II – Organizimi dhe Funksimi i Administratës Publike

Politikat nën këtë shtyllë synojnë rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj publikut dhe përafrimin më të shpejtë me standardet dhe kërkesat e BE-së nëpërmjet përdorimit të mjeteve inovative dhe sporteleve unike. Gjithashtu synohet përmirësimi i mënyrës së funksionimit dhe organizimit të administratës publike nëpërmjet fuqizimit të strukturave institucionale.

Objektivat e planifikuara në kuadër të Shtyllës II synojnë:




Fuqizimin e strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut.




Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin e etikës në ofrimin e shërbimeve publike

Shtylla II “Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike” parashikon realizimin e 18 nën-aktiviteteve nga të cilat kanë filluar të zbatohen 17 nën-aktivitete (ose 94%) e prej këtyre të fundit janë realizuar plotësisht 12 nën-aktivitete ose 71%.


Grafiku 9 - Progresi për qëllimin politik: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike




Grafiku 10 - Statusi i realizimit të qëllimit politik: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike



Grafiku 11 - Numri i produkteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 12 - Statusi i realizimit të produkteve sipas Objektivave



Në kuadër të reformës strukturore të institucioneve të administratës publike si pjesë e rëndësishme e reformës në administratën publike, tashmë ka përfunduar puna për riorganizimin e katër sistemeve ministrore, të shëndetësisë, arsimit, turizmit dhe bujqësisë.

I gjithë procesi është bazuar në qasjen metodologjike për riorganizimin e institucioneve dhe është mbështetur në ligjin 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore” dhe akteve të tjera mbështetëse nënligjore¹.

Gjatë vitit 2020, paralelisht me punën [phttp://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjikr](http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjikr) zbatimin me sukses të strukturave të ministrive të linjës, procesi i ristrukturimit të institucioneve të varësisë është ndjekur nga hartimi i të gjitha rregulloreve të nevojshme (rregulloret e funksionimit etj.) për zbatimin e reformës për institucionet e riorganizuar në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

¹ VKM nr. 2014/893, Urdhri e Kryeministrit nr. 2018/59 si dhe në konkluzionet e Komitetit Drejtues të Reformës Strukturore ku Departamenti i Administratës Publike ka rolin e sekretariatit teknik që nga Tetori i vitit 2019.

Në sistemin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë bërë disa riorganizime ku ministria është lehtësuar nga procedurat e procesit të shpronësimit ose përdorimit të përkohshëm për interes publik të pasurive të personave fizikë ose juridikë privatë në të gjithë vendin përmes krijimit të Agjencisë Shtetërore të Shpronësimit².

Për sistemin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në zbatim të ligjit Nr. 75/2019, "Për të rinjtë" u riorganizua Agjencia Kombëtare e Rinisë³ duke synuar një rregullim më të mirë të funksioneve dhe përgjegjësi midis strukturave përgjegjëse për rininë midis nivelit qendror dhe lokal dhe për të rritur bashkëpunimin me organizatat e tjera në programe dhe projekte në fushën e rinisë.

Gjatë 2020 është krijuar Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve⁴, institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ky institucion do të organizohet dhe operojë në nivelin qendror në formën e drejtorisë së përgjithshme dhe në nivel rajonal, nëpërmjet katër drejtorive rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve dhe njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve veterinarë si dhe do të ketë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimit veterinar për kafshët dhe në sigurinë e ushqimeve me origjinë shtazore. Krijimi i tij vjen në vijimësi të reformës që ka nisur me Shërbimin Kombëtar Veterinar, duke garantuar shëndetin e kafshëve dhe sigurinë ushqimore si një prioritet kryesor i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Për të konsoliduar akoma dhe më tej mirëfunksionimin e institucioneve publike (pas rristurimit të ministrive të linjës dhe institucioneve të varësisë), po zbatohen paralelisht disa aktivitete me mbështetjen e projektit IPA 2014 "Zbatimi i reformës së shërbimit civil në të gjithë administratën publike". Disa nga aktivitetet që janë në proces janë rishikimi i përshtatjeve të punës për ministritë e linjës dhe përcaktimi i proceseve të punës në të gjitha ministritë e linjës (20 procese horizontale dhe 5 vertikale për secilën ministri)⁵.

Në drejtim të ofrimit të mbështetjes për funksionimin e Njësive të Qeverisjes Vendore dhe forcimit të kapaciteteve zbatuese, me mbështetjen e projektit STAR 2 të financuar nga UNDP, është vënë në funksion sistemi informatik i zyrave më një ndalesë (OSSIS) në 59 njësi të vetëqeverisjes vendore. Përmes këtij sistemi ofrohen mbi 70 shërbime dhe janë regjistruar 11,951 aplikime për shërbime administrative.

Për të mundësuar përdorimin e duhur të sistemit OSSIS janë trajnuar 1716 punonjës ose 70% e stafit të njësive administrative vendore.

Gjatë vitit 2020 Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) ka vijuar punën në drejtim të ngritjes së qendrave të reja të shërbimeve të integruara dhe mirëadministrimin e tyre me shtimin e 6 Qendrave të reja të integruara në Lushnjë, Elbasan, Pogradec, Mat, Roskovec dhe Kolonjë duke e çuar kështu në 20 numrin e qendrave në total dhe duke e tejkaluar përcaktimin në dokumentin strategjik, të ngritjes së së paku 9 qendrave të integruara.


² Miratuar me vendim Nr. 396, datë 13.05.2020 «Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Shpronësimit»

³ Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 681, datë 2.09.2020 «Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë».

⁴ Miratuar me vendim Nr. 683, datë 2.09.2020 «Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve».



⁵ Indikator 4a "Shkalla në të cilën strukturat e ministrive dhe institucionet e tjera janë racionale dhe koherente (indikator i SIGMA-s)" shënon vlerën 2 në matjen e tij më të fundit, realizuar nga SIGMA në 2017. Linku i SIGMA për të aksesuar raportet e tyre të vlerësimit për vendin: <http://www.sigmaxweb.org/publications/>.

Grafiku 13 - Numri i qendrave të integruara ADISA sipas objektivave në vite



Vlen për t'u përmendur se në këto qendra infrastruktura është përshtatur edhe për personat me aftësi të kufizuara duke ofruar informacion të përshtatur dhe në gjuhën e shenjave. Gjithashtu qendrat janë pajisur me sistemin elektronik të menaxhimit të radhës, duke ofruar kushte më të mira në marrjen e shërbimeve publike për të gjithë qytetarët.

Gjatë vitit 2020, në Qendrat e Integruara ADISA janë ofruar mbi 1000 shërbime publike të institucioneve qendrore dhe vendore nëpërmjet portalit e-Albania. Në këto qendra janë kryer 558,521 aplikime, 227,371 persona janë asistuar në sportelet e informacionit, 88,968 persona janë asistuar për shërbimet online dhe janë depozituar 3,704 ankesa nëpërmjet portalit "ShqipëriaQeDuam.al".



Qendra të integruara të hapura gjatë 2020

Për shkak të situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar prej pandemisë Covid-19 dhe pamundësisë për të respektuar rregullat e distancimit social, njësia lëvizëse nuk ishte funksionale gjatë pjesës më të madhe të vitit 2020. Duke u solidarizuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ADISA vendosi në dispozicion të stafit të Njesisë së Kujdesit Shëndetësor njësine lëvizëse për të kryer testime për Covid-19 për banorët të cilët ndodhen në zona të thella rurale dhe nuk kanë mundësi të shpejta aksesit në qendrat shëndetësore.



*Njësia lëvizëse
ADISA në shërbim të
sistemit shëndetësor*

Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve ka vijuar me ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e trajnimeve për stafin e ADISA, trajnime të cilat janë zhvilluar online për shkak të situatës së krijuar nga pandemia. Për institucionet qendrore janë zhvilluar 33 trajnime dhe janë trajnuar 89 punonjës në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara.



Vlera 2020

820


INDIKATORI 5A

**NUMRI I SHËRBIMEVE TË QEVERISË QENDRORE ME NDËRVEPRIM
TË PËRMIRËSUAR NË ZYRAT E PRITJES**

Indikatori 5a shënon një trend rritës që prej fillimit të matjes së tij në vitin 2015. Në sportelet pritëse në Qendrat e Integruara në Tiranë 1, Kavajë, Krujë, Fier, Gjirokastrë, Shkodër, Tiranë 2 (Kombinat), Maliq, Belsh, Patos, Librazhd, Divjakë, Malësi e Madhe, Kukës, Lushnjë, Elbasan, Pogradec, Mat, Roskovec dhe Kolonjë ofrohen 750 shërbime të 46 institucioneve qendrore dhe 70 shërbime vendore për një total prej 820 shërbimesh publike (vlera e indikatorit për vitin 2019: 429 shërbime; për vitin 2018: 367 shërbime)⁶. Kjo rritje e konsiderueshme ka ardhur si rezultat i investimeve të vazhdueshme dhe të rëndësishme të bëra nga qeveria shqiptare në funksion të përmirësimit të shërbimeve dhe ofrimit të tyre me më pak kosto dhe me më shumë cilësi e transparencë.

⁶ Target: 300 shërbime. Indikatori është arritur.

Grafiku 14 - Numri i shërbimeve të ofruara me ndërveprim të përmirësuar



Vlera 2020

97 %
e bashkive


INDIKATORI 5B

NUMRI I ZYRAVE ME NJË NDALESË TË NGRITURA NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Indikatori 5b ka shënuar një rritje të konsiderueshme gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020⁷. Numri i bashkive që aplikojnë programin e shërbimeve online të ofruara nga sportelet unike është 59 në total nga 61 bashki. Megjithatë, përpos rritjes, nuk është arritur objektivi i vendosur për vitin 2020 për të ngritur One Stop Shop në të gjitha bashkitë. Kjo sepse bashkitë Pustec dhe Has kanë pasur probleme në kapacitete për të implementuar sistemet One Stop Shop. Gjithsesi, vlen të theksohet se nëpërmjet përdorimit të sistemit OSSIS bashkitë ofrojnë një numër të konsiderueshëm shërbimesh (76 shërbime, me përjashtim Tiranën, e cila ofron 135 shërbime).

Ky indikator ka shënuar ndër vite një progres të konsiderueshëm sidomos gjatë vitit 2020. Me qëllim përfshirjen e dy bashkive të mbetura dhe vënies në funksion të sistemit informatik OSSIS dhe mundësimin të shërbimeve me një ndalesë për qytetarët, do të duhej rritja e aftësive të këtyre bashkive për të përkthyer ndihmën e dhënë nga asistenca e projekti STAR 2 në veprime konkrete dhe kryerja e investimeve në fushën e teknologjisë së informacionit për të mundësuar realizimin e plotë të këtij treguesi.

Grafiku 15 - Numri i zyrave me një ndalesë të ngritura në njësitë e qeverisjes vendore



⁷ Target: 100 % e bashkive. Indikatori nuk është arritur edhe pse shënon një progres të dukshëm ndër vite: në nivelin 96.7 % për 2020; 70 % për 2019 dhe 23% në vitin 2018.

Shtylla III – Shërbimi Civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Politikat nën këtë shtyllë synojnë rritjen e kapaciteteve, transparencës dhe përgjegjshmërisë për zbatimin në mënyrë të unifikuar të legjislacionit të shërbimit civil në të gjitha nivelet si dhe rishikimin e përmirësimin e sistemit të pagave në shërbimin civil.

Objektivat e planifikuara në kuadër të Shtyllës III synojnë:




Rritjen e kapaciteteve në fushën e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil si dhe lehtësimin e procedurave në zbatim të tij




Organizimi i sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme

Shtylla III "Shërbimi Civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore" parashikon realizimin e 36 nën-aktiviteteve, nga të cilat 32 nën-aktivitete kanë filluar të zbatohen (ose 89%), e prej këtyre të fundit janë realizuar plotësisht 15 nën-aktivitete ose 47%.


Grafiku 16 - Progresi për qëllimin politik: Shërbimi Civil, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore




Grafiku 17 - Statusi i realizimit të qëllimit politik: Shërbimi Civil, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore



Grafiku 18 - Numri i produkteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 19 - Statusi i realizimit të produkteve sipas Objektivave



Shërbimi Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është fusha në të cilën Shqipëria ka vite tashmë që mban vendin e liderit në Ballkanin Perëndimor duke u vlerësuar nga organizma rajonale e evropiane me pikët më të larta në krahasim me vendet e tjera.

Gjatë vitit 2020, përpos të gjithë vështirësive dhe sfidave që derivuan nga situata e pandemisë globale, Shqipëria ndërmori masat e nevojshme për të kapërcyer gjendjen e jashtëzakonshme dhe për t'u rikthyer drejt funksionimit normal të institucioneve të administratës publike. Të gjitha masat dhe iniciativat e ndërmarra në vitet e fundit në drejtim të modernizimit të administratës publike dhe proceseve, procedurave dhe shërbimeve të ofruara, i shërbyen Shqipërisë të kapërcente vështirësitë dhe kufizimet e shkaktuara nga kriza globale shëndetësore dhe jo vetëm.

Kështu gjatë vitit 2020, Shqipëria ishte përsëri vendi i parë në rajon i cili implementoi me sukses rekrutimin plotësisht online në shërbimin civil, duke mundur vijimin e këtij procesi të rëndësishëm në institucionet shtetërore duke zbatuar rregullat e distancimit fizik.

Me shpalljen e gjendjes së pandemisë në fillim të Marsit, Qeveria Shqiptare miratoi një sërë masash kufizuese për të parandaluar përhapjen e virusit në vend. Kështu me Urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u ndaluan grumbullimet e njerëzve çka bëri automatikisht të pamundur zhvillimin e procedurave të rekrutimit në institucionet shtetërore pjesë e shërbimit civil, të cilat menaxhohen nga DAP.

Ndodhur në këtë situatë, DAP filloi punën për analizimin e mjeteve dhe instrumentave në dispozicion dhe dizajnimin e zgjidhjeve dhe metodave teknologjike për të përshtatur platforma online në funksion të zhvillimit të procedurave të konkurrit, duke respektuar masat për parandalimin e COVID-19.

Kështu në Prill 2020, u mundësua për herë të parë në vend dhe në rajon, zhvillimi i një procedure rekrutimi në institucionet shtetërore, pjesë e shërbimit civil, plotësisht online. Mundësimi i procesit të rekrutimit totalisht online ishte një zhvillim i rëndësishëm për administratën publike shqiptare, një zhvillim i cili u mundësua nga "Administrata.al", platforma inovative në menaxhimin e burimeve njerëzore, financuar nga Këshilli i Evropës dhe të qeverisë Zviceriane. Një arritje e tillë për vendin u prezantua si rast suksesi në rajon e me gjerë, nëpërmjet takimeve të organizuara nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA) si dhe [SIGMA/OECD](#).

Që prej ngritjes së saj në 2019, kjo platformë ka shënuar një transformim thelbësor në mënyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike shqiptare duke lehtësuar jo vetëm punën e profesionistëve të burimeve njerëzore në realizimin e procedurave dhe proceseve kryesore të menaxhimit të kapitalit human por edhe punën e institucioneve monitoruese si DAP dhe KMSHC për të kontrolluar zbatimin rigoroz të legjislacionit të shërbimit civil.

Platforma konfirmoi akoma më shumë vlerën e saj të shtuar gjatë periudhës së pandemisë pasi jo vetëm bëri të mundur realizimin e proceseve të rekrutimit plotësisht online por dhe shërbeu si një vend pune virtual për profesionistët e burimeve njerëzore.



Pamje nga Front Page
i "administrata.al"

Ndërkohë në drejtim të realizimit të një prej objektivave më të rëndësishëm të platformës së integruar të komunikimit "administrata.al" që është unifikimi dhe standartizimi i procedurave dhe proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjithë shërbimin civil (nivel qendror dhe lokal), DAP ka bashkëpunuar ngushtësisht me KMSHC duke zhvilluar komunikime dhe takime periodike për të përgatitur një set indikatorësh të përbashkët për monitorimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil.

Seti i indikatorëve i hartuar me mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare të projektit "Implementimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike" financuar nga fondet IPA, do të sigurojë të dhëna të sakta dhe të plota mbi zbatimin e instituteve kryesore të legjislacionit të shërbimit civil duke mundësuar kështu një kontroll dhe monitorim në kohë reale të punës së njësive të burimeve njerëzore në shërbimin civil. Nëpërmjet të dhënave, informacionit dhe monitorimit në kohë reale, sigurohet kështu realizimi i saktë dhe me efikasitet të detyrave funksionale të profesionistëve të burimeve njerëzore në shërbimin civil në të gjithë nivelet e administratës publike, me rezultat përfundimtar mirëmenaxhimit të burimeve njerëzore.



Takim me KMSHC për monitorimin në
kohë reale të indikatorëve të menaxhimit
të burimeve njerëzore, Janar 2020.

Një administratë publike e cila realizon me sukses mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore, është e aftë të kryejë me efektivitetet funksionet dhe detyrat e saj dhe ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj publikut, në mënyrë transparente. Në këtë kuadër, platforma “administrata.al” ka facilituar punën gjithashtu duke vënë në dispozicion të nëpunësve civilë të gjithë bazën ligjore, template të gatshme dhe module me hapa të detajuar për procese të rëndësishme të menaxhimit të burimeve njerëzore në shërbimin civil si ristrukturimi, rekrutimi, vlerësimi i rezultateve në punë, përshkrimi i punës etj.

Platforma përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga DAP, duke siguruar kështu që nëpunësit civilë të kenë çdo mjet në dispozicion për të realizuar çdo procedurë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Një proces i tillë është realizuar më një fokus më të veçantë drejt punonjësve të shërbimit civil në nivel lokal, për të siguruar mbushjen e boshllëqeve sa i takon njohurive dhe kapaciteteve për të menaxhuar në mënyrë të pavarur nëpunësit civilë të tyre.

Një tjetër aspekt në të cilin bashkëpunimi i DAP me KMSHC dhe institucionet publike ka sjellë rezultate të dukshme është dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në administratën publike. Gjatë këtyre viteve, DAP ka bërë përpjekje të vazhdueshme për përfshirjen e gjerë dhe aktive të të gjithë institucioneve ligjzbatuese shtetërore në këtë proces, përmes unifikimit dhe orientimit të drejtë e me efikasitet të procedurave administrative dhe përmes ndjekjes dhe monitorimit nga afër të të gjithë procesit për të garantuar zbatimin e procedurave sipas legjislacionit në fuqi.

Ndjekja e këtij procesi është lehtësuar dhe përmirësuar falë përdorimit të platformës “Administrata.al”, ku institucionet e administratës shtetërore raportojnë në mënyrë të detajuar për të dhënat mbi vendimet gjyqësore të formës së prerë, duke mundur kështu mbikëqyrjen efektive për sistemin e gjyqfituesve rast pas rasti. Institucionet kanë detyrimin eksplicit për të raportuar në këtë sistem me të dhëna të sakta periodike dhe transparente, duke i dhënë kështu mundësinë DAP dhe KMSHC të jenë në dijeni dhe të ushtrjnë në kohë kompetencat e tyre mbikëqyrëse. Monitorimi nga afër i procesit, asistenca dhe mbikëqyrja kanë sjellë rezultate pozitive duke bërë që numri i vendimeve gjyqësore të zbatuara në fund të vitit 2020 të jetë në nivelet 275.


Të gjitha sa më sipër, janë masa të ndërmarra në funksion të rritjes së transparencës dhe monitorimit të punës së nëpunësve civilë duke rritur kështu përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e tyre gjatë ushtrimit të detyrave të tyre të përditshme.

Megjithatë qëllimi DAP vijon të mbetet përmirësimi i vazhdueshëm dhe i mëtejshëm i performancës së administratës publike si çelësi i zbatimit të çdo mase apo iniciative të ndërmarrë nga qeveria me qëllim zhvillimin e vendit.

Sigurimi i një performance të denjë nga administrata publike, fillon që me rekrutimin e më të mirëve në rradhët e saj çka është dhe ndër objektivat kryesorë të DAP, në realizimin e të cilit departamenti vijon të zhvillojë trajnime dhe asistencë për anëtarët e Komisioneve të Vlerësimit, të cilët luajnë një rol kyç në procedurat e rekrutimit në shërbimin civil. Sa i përket forcimit të kapaciteteve të nëpunësve në menaxhimin e burimeve njerëzore janë zhvilluar sesione trajnimi me qëllim kryesor zhvillimin e aftësive, njohurive dhe profesionalizimit të stafit të ri të DAP duke u fokusuar kryesisht në referimin e shembujve konkret nga procedurat e rekrutimit të viteve të fundit.

Gjatë vitit 2020, me zhvillimin e procedurave të rekrutimit plotësisht online, sfida e DAP ishte familjarizimi i menjëhershëm i anëtareve të Komisioneve të Vlerësimit me këtë realitet të ri e akoma më shumë familjarizimi i aplikantëve me metodat inovative të diktuar nga situata në

vend. Për t'iu ardhur në ndihmë aplikantëve mbi ndryshimet e reja në mënyrën e zhvillimit të procedurave të rekrutimit si dhe rritjen e kuptueshmërisë së kandidatëve ndaj këtyre fazave të rekrutimit, përveç asistimit nëpërmjet kanaleve të komunikimit të vendosura në dispozicion të publikut, DAP hartoi dhe publikoi dy udhëzues të detajuar për zhvillimin online të testimit me shkrim dhe intervistës. Udhëzuesit orientojnë aplikantin për çdo hap të procesit, për të minimizuar kështu vështirësitë, gabimet apo vonesat gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit. Në këtë kuadër, specifikisht për testimin me shkrim, tashmë online, pjesëmarrësve u është mundësuar gjithashtu hyrja në një ambient prove për t'u familiarizuar me mënyrën e plotësimit të testimit. Të gjitha këto, si elementë për të siguruar cilësinë dhe transparencën në realizimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil.



Intervistime ONLINE

Eksperiencia e përfituar gjatë periudhës së kufizimeve të vendosura për mospërhapjen e Covid19, tregoi që zhvillimi i procedurave të rekrutimit plotësisht online solli disa përfitime të dukshme si rritja e pjesëmarrjes, efienca kohore dhe efektiviteti në kosto.

AVANTAZHET E REKRUTIMIT ONLINE (E-RECRUITMENT)




Duke analizuar me kujdes sfidat kryesore, DAP në përputhje me rregulloret e distancimit fizik i është rikthyer alternimit të zhvillimit të procedurave online të rekrutimit dhe në ambiente të cilat lejojnë distancimin fizik midis kandidatëve si dhe midis kandidatëve dhe anëtarëve të komisioneve të vlerësimit.



Zhvillimi i testimit sipas rregullave të distancimit fizik

Departamenti i Administratës Publike ka asistuar të gjithë aplikantët duke dhënë informacion dhe përgjigje mbi kërkesat e tyre në kohë reale. Tashmë kanali i DAP në Facebook përditësohet në mënyrë të vazhdueshme me lajme, grafikë informues dhe udhëzime mbi motivimin, punën në distancë dhe çështje të tjera në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore.



Për shkak të këtyre ndryshimeve në anën vizuale dhe në paraqitjen më të thjeshtë të proceseve të përditshme të punës, faqja e DAP në Facebook ka shënuar rritje të numrit të ndjekësve të saj dhe numëron 18,277 ndjekës.

Me mbështetjen e projektit “Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në administratën publike”, financuar nga programet IPA të BE, janë zhvilluar disa produkte kyçe të cilat kanë një ndikim të drejtëpërdrejtë në performancën e administratës publike e kështu dhe në shërbimet që kjo administratë i ofron qytetarit.

Manuali i vlerësimit të rezultateve në punë, është një ndër produktet i cili pritet të përmirësojë sistemin e vlerësimit të nëpunësve civilë, duke lehtësuar procedurën e vlerësimit të rezultateve në të gjitha fazat e tij, rritur objektivitetin gjatë vlerësimit dhe promovuar dialogun ndërmjet eprorit dhe nëpunësit, pra duke e kthyer këtë proces në bashkëpunim të ndërsjellë me synimin përfundimtar rritjen e performancës së nëpunësve civilë në vendin e punës. Një vlerësim performancë objektiv dhe i drejtë është një ndikues i drejtëpërdrejtë në motivimin dhe vetëvlerësimin e nëpunësit e për rrjedhojë dhe për performancën e tij.

Manuali i përshkrimeve të punës dhe dizenjimi i proceseve të punës në ministritë e linjës janë dy produkte të tjera thelbësore për mirëfunksionimin e administratës publike, të cilat janë drejt finalizimit me mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare edhe vendase. **Përshkrimet e punës të përmirësuara**, më të qarta, të orientuara drejt rezultateve dhe proceset e punës të detajuara hap pas hapi, të standartizuara dhe unifikuar në cdo ministri linje, janë kushtet të rëndësishme të cilat ndihmojnë nëpunësit tanë civilë të përmbushin detyrat e tyre funksionale me maksimumin e efikasitetit dhe minimumin e gabimeve.

Në kuadër të digjitalizimit të proceseve dhe sistemeve dhe të përpjekjeve për të rritur efikasitetin e punës së nëpunësve publikë, prej disa vitesh tashmë kemi një Sistem Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) i cili përmban rreth 63`000 dosje personeli të nëpunësve publikë. HRMIS që prej 2018 nuk shërben vetëm si një Regjistër Elektronik Qendror Personeli por nëpërmjet tij realizohet gjithashtu gjenerimi i borderosë për deri në 118 njësi shpenzuese në administratën publike shqiptare. Megjithatë, synimet për këtë sistem janë akoma më të mëdha pasi me lidhjen e HRMIS me sistemin e thesarit dhe përfundimin e të gjithë testeve të nevojshme gjatë 2020, vitin e ardhshëm do të jetë i mundur automatizmi i pagave nëpërmjet sistemeve të informacionit. Një digjitalizim i tillë i një procesi kaq të rëndësishëm sa kalkulimi i pagave për nëpunësit publikë, do të sjellë rritje të efikasitetit, duke minimizuar pasaktësitë dhe duke ofruar të dhëna lehtësisht të përpunueshme për efekt raportimesh, projektash apo politikash. Edhe pse institucionet publike janë ndërgjegjësuar lidhur me benefitet që sjell përdorimi periodik i HRMIS, popullimi i tij me të dhëna dhe përditësimi i vazhdueshëm mbeten një sfidë në vetvete të cilën DAP është përpjekur ta kapërcejë me disa masa të tërthorta si psh: lidhja e sistemit me gjenerimin e pagave apo lidhja e sistemit me shpalljen e vendeve vakante. E akoma më tej, një masë tjetër e ndërmarrë në 2020 ishte miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrin qendror të personelit”, vendim i cili ndër të tjera parashikon në mënyrë evidente detyrimin e institucioneve për të përditësuar HRMIS.

Indikatori 6a llogaritet duke pjestuar numrin e stafit drejtues në të gjitha nivelet e shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore, të cilët janë larguar nga pozicionet e tyre në një vit, me numrin total të stafit drejtues në administratën qendrore në vitin e dhënë. Numri i stafit drejtues të larguar gjatë vitit 2020 është 76 nga totali i stafit drejtues prej 959 në një vlerë po thuaj të njëjtë me një vit më parë (vlera e këtij indikatori për vitin 2019 dhe 2018 është 8%). Ruajtja e një trendi të njëtrajtshëm tregon për një qëndrueshmëri të nëpunësve pjesë e shërbimit civil.



Vlera 2020

8%

INDIKATORI 6A

QARKULLIMI VJETOR I STAFIT TË NIVELIT DREJTUES NË TË GJITHA NIVELET E SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE

Indikatori 6b1² llogaritet duke pjestuar numrin total të pjesëmarrësve nga jashtë shërbimit civil që aplikojnë për një pozicion ekzekutiv (25904) me numrin total të pozicioneve të shpallura në kategorinë ekzekutive në vitin e dhënë (806), duke rezultuar në një numër mesatar pjesëmarrësish prej 32.1, një vlerë më e lartë me një vit më parë (Vlera e këtij indikatori për vitin 2019 ishte 13.62; për vitin 2018 ishte 13). Ky trend tregon rritjen e besueshmërisë së publikut për pjesëmarrje në procedurat e rekrutimit të bazuar në meritë, e cila ka ardhur si pasojë e punës së DAP në drejtim të respektimit rigoroz të legjislacionit, transparencës me publikun, aktiviteteve në funksion të rritjes së vizibilitetit etj.



Vlera 2020

32.1

INDIKATORI 6B - 1

NUMRI MESATAR I PJESËMARRËSVE NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL QË MARRIN PJESË NË NJË PROCEDURË REKRUTIMI

1 Target: Tendencë në rënie. Indikatori nuk është arritur dhe shënon vlerë konstante.
2 Shënohet rritje me 18.48

Indikatori 6b2³ llogaritet duke pjestuar numrin total të pjesëmarrësve nga shërbimi civil nga të gjitha grupet që marrin pjesë në një procedurë rekrutimi (2980) me numrin total të pozicioneve për të cilat ka patur aplikime (806), duke rezultuar në një numër mesatar pjesëmarrësish prej 3.7, një vlerë më e lartë se një vit më parë ku shënohej vlera 2.5 (vlera e indikatorit për 2018 ishte 1.5). Trendi rritës i këtij indikator tregon se një ndër rritje të legjislacionit të shërbimit civil, ai i mobilitetit, është gjithnjë e më shumë në zbatim, duke i dhënë shërbimit civil dinamizëm dhe energji të reja.



Vlera 2020

3.7

INDIKATORI 6B - 2

NUMRI MESATAR I PJESËMARRËSVE BRENDA SHËRBIMIT CIVIL QË MARRIN PJESË NË NJË PROCES REKRUTIMI

Sa i takon **indikatorit 6c**, nga viti 2014 deri në vitin 2020 ka qënë vetëm 1 rast ankese në lidhje me procedurat e rekrutimit të pranuar nga gjykata Administrative e Apelit. Vendimi i formës së prerë është ekzekutuar nga ana e DAP në Tetor 2019. Ndërkohë, për vitin 2020 nuk ka pasur asnjë ankesë të pranuar nga gjykata Administrative e Apelit në lidhje me procedurat e rekrutimit. Ky indikator është arritur plotësisht duke shënuar tendencë në rënie të numrit të ankesave krahasimisht me vlerën bazë të vendosur në 2015 ku numri i ankesave ka qënë 3. Numri i ulët (pothuajse 0) i ankesave të pranuar nga gjykata Administrative e Apelit tregon për një zbatim rigoroz të legjislacionit përkatës për rekrutimin e nëpunësve civilë duke përfshirë këtu Ligjin nr.152 për “Nëpunësin Civil” dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, për organizimin e procedurave transparente në mënyrë profesionale dhe bazuar në meritë si dhe e mbrojtjes profesionale që kanë ofruar strukturat e përfaqësimit gjyqësor pranë Departamentit të Administratës Publike.



Vlera 2020

0

INDIKATORI 6C

NUMRI I ANKESAVE QË KANË TË BËJNË ME REKRUTIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL TË PRANUAR NGA GJYKATA (DUKE FILLUAR NGA GJYSMA E DYTË E VITIT 2014) KA SHËNUAR RËNIE

Në lidhje me procedurat administrative dhe mbikëqyrjen në institucionet e pushtetit qendror, vendor dhe ato të pavarura, në kushtet e pandemisë Covid 19, është riorganizuar veprimtaria e **Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil** duke i dhënë përparësi realizimit online të procesit të mbikëqyrjes.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer 73 mbikëqyrje të përgjithshme që përfshijnë të gjithë veprimtarinë e administrimit të shërbimit civil për periudhën Janar – Dhjetor 2020 në administratën vendore. Në përfundim të afatit të paralajmërimit për rregullimin e ligjshmërisë është kryer procesi i verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit në 49 institucione. Në përfundim të verifikimit procesi është përmbyllur me vendim të Komisionerit për 25 subjekte duke i vlerësuar si të përmbushura detyrat e lëna, ndërsa për 24 subjekte Komisioneri ka vendosur që procesin e rivendosjes së ligjshmërisë ta realizojë duke ndihmuar institucionin me asistencë teknike e cila ka nisur me hartimin e një plani veprimi me masa dhe afate kohore konkrete të veprimeve administrative që do të kryhen nga personat përgjegjës.

Gjithashtu është verifikuar zbatimi i vendimeve paralajmëruese të Komisionerit për 12 raste individuale ku në 7 raste detyrat e lëna janë zbatuar në mënyrë vullnetare nga ana e institucioneve dhe në 5 raste procesi është drejt përmbylljes së tij.

Procesi i mbikëqyrjes ka vijuar me trajtimin e 142 kërkesave individuale ku një pjesë e tyre janë ndjekur përmes inspektimit/mbikëqyrjes. Kërkesave të tjera iu është kthyer përgjigje në rrugë administrative si dhe është marrë vendim në ato raste ku është vlerësuar për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë. Për rastet e tjera Komisioneri ka dalë me vendim për përfundimin e verifikimit pasi nuk janë konstatuar shkelje apo ka përfunduar inspektimi me njoftim arkivimi⁴.

Ka vijuar gjithashtu procesi i monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë, përmes zhvillimit të seancave dëgjimore për të gjitha ministritë. Gjatë vitit 2020, fokusi ka qenë për të përfunduar këtë proces në administratën vendore, për të cilin është mbledhur informacion nga 61 bashkitë e vendit dhe 12 këshillat e qarqeve.

Në zbatim të kompetencës ligjore për të mbikëqyrur administrimin e shërbimit civil, bazuar në nenin 14 dhe 15 të ligjit nr. 2013/152, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; në zbatim të planit vjetor të veprimtarisë së institucionit, Komisioneri ka filluar përgatitjen e procesit të mbikëqyrjes për të siguruar zbatimin e ligjit për nëpunësin civil në kushtet e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Aktiviteti i **Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)** gjatë vitit 2020 ka patur synim kryesor ngritjen e kapaciteteve dhe përgatitjen e administratës publike shqiptare në drejtim të integritetit evropian dhe zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil. Për eksperiencën pozitive në vijimin e zhvillimit të kapaciteteve gjatë kohës së pandemisë ASPA u vlerësua me çmimin "Public Administration Award 2020", në kategorinë e-Learning, organizuar nga RESPA dhe OECD për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Viti 2020 ishte një vit sfidues për mbarëvajtjen dhe veprimtarinë e Shkollës së Administratës Publike ku trajnimet tradicionale të zhvilluara në klasë u zëvendësuan me trajnime të zhvilluara tërësisht online nga muaji Prill 2020. Për t'i paraprirë sfidës së kalimit të trajnimeve online u zhvilluan sesione trajnimi për trajnerët me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre për përdorimin e platformave dhe përshtatjen e materialeve për trajnim.


Me përgatitjen e kushteve të nevojshme u mundësua mbajtja e Webinarit të parë live të zhvilluar më 13 Prill 2020 me temën "AGILE leadership".

Krahas problematikave të hasura u arrit që të gjitha shërbimet e shkollës të realizoheshin në ambjentet virtuale me të njëjtën dinamikë dhe cilësi në ofrimin e shërbimit⁵.

Përveç përdorimit të platformave online tashmë të njohura dhe me efekte pozitive në ndërveprim dhe komunikim, u arrit që gjatë vitit 2020 të vihej në funksion dhe platforma e re e krijuar për menaxhimin e të nxënës (Learning Management System) ku pritjet në vijim të përditësohet me kurrikulat e-learning sipas fushave dhe tematikave bazë dhe atyre të evidentuara nga vlerësimi i nevojave për trajnim. Përmes sistemit LMS janë zhvilluar trajnime mbi Kodin e Procedurave Administrative të organizuara nga DAP në mbështetje të projektit IPA 2014 «Zbatimi i reformës së shërbimit civil në të gjithë administratën publike» ku në total u trajnuan dhe u certifikuan rreth 160 nëpunës.

⁴ Nga totali 10 raste janë përfshirë në inspektim/mbikëqyrje, në 18 raste iu është kthyer përgjigje në rrugë administrative, në 33 raste është dhënë vendim për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë, në 38 raste është dhënë vendim për përfundimin e verifikimit pasi nuk janë konstatuar shkelje, në 25 raste ka përfunduar inspektimi dhe në 18 raste janë mbartur për në vitin 2021.

⁵ U ofruan webinarë live, kurse me certifikim, klubi i librit online dhe masterclass.




Trajnimi online i zhvilluar përmes metodës inovative LMS



Gjatë vitit 2020 u mundësua trajnimi i **4630** individëve si (janë shënuar 20,106 pjesëmarrës) duke shënuar kështu një rritje të numrit të individëve që rikthehen të marrin shërbim. Një tjetër tregues pozitiv për 2020 është zhvillimi i 769 kurse trajnimi krahasuar me vitin 2019 gjatë të cilit ASPA zhvilloi 698 kurse. Pra, janë ofruar më shumë shërbime për të njëjtët individë të cilët janë rikthyer duke treguar edhe përmbushjen e kënaqësisë së klientit. Duhet të nënvizohet që numri i pjesëmarrësve në vitin 2020 është ndikuar edhe nga aksesit në teknologjinë online sepse trajnimet e periudhës Prill-Dhjetor 2020 të ASPA kanë qënë tërësisht online dhe pamundësia e aksesit në teknologji ndikon drejtëpërdrejtë në këtë indikator.

Tashmë është zhvilluar një sistem efektiv për vlerësimin e trajnimit, që gjeneron më shumë të dhëna lidhur me cilësinë e trajnimit, arritjen e objektivave dhe matjen e ndikimit të trajnimit në performancën individuale të institucionit dhe të sistemit në tërësi. Në përfundim të çdo trajnimi shpërndahen formularët e vlerësimit, të dhënat e të cilëve analizohen për të përmirësuar cilësinë e trajnimit, konkretisht me rezultate si më poshtë për 2020⁶.

Grafiku 20 - Kënaqësia e Klientit



⁶ Nga analizimi i mendimit të pjesëmarrësve në trajnimet online për 4688 pyetësorë të plotësuar 99.21 % nëpunës janë përgjigjur se kanë interes të ndjekin webinar tjetër të ASPA, 86.36 % janë përgjigjur se e vlerësojnë webinarin/trajnimin që kanë ndjekur me "shumë mirë" dhe 78.03 % janë përgjigjur se pritshmëritë e tyre për webinarin që kanë ndjekur janë realizuar plotësisht.


Në drejtim të arritjes së objektivave për ofrimin e një numri më të madh të trajnimeve në fushën e integritit evropian, gjatë 2020 janë trajnuar 2730 pjesëmarrës duke realizuar plotësisht masën e parashikuar në planin e veprimit të SNRAP për rritjen e përqindjes që zënë programet në fushën e integritit evropian nga 30 % në vitin 2018 në 50 % deri në vitin 2020. Në vitin 2018 ASPA ka ofruar 2 module në fushën e integritit evropian, ndërsa në vitin 2020 ka ofruar 6 module, pra tre fishin e tyre.

Përveç këtyre moduleve, në kuadër të procesit të hapjes së negociatave janë zhvilluar trajnime specifike për anëtarët e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian (GNPIE) për 6 kapitujt e ACQUIS. Gjithashtu gjatë vitit 2020 u trajnuan në fushën e integritit evropian në mënyrë të dedikuar edhe pjesëmarrës nga pushteti vendor. Ngritja e kapaciteteve ka vijuar dhe në fushën e **barazisë gjinore; financave publike; prokurimit publik; teknologjisë; zhvillimit personal; menaxhimit të organizatës; dhe lidhshmërisë**.

Treguesit e ASPA për vitin 2020⁸

4630	NËPUNËS TË TRAJNUAR
769	KURSE TRAJNIMI
564	DITË TRAJNIMI
20106	NËPUNËS CIVILË PËR DITË TRAJNIMI (PJESËMARRËS)

Grafiku 21 - Statistika të trajnimit për periudhën 2018 - 2020



⁷ Në fushën e barazisë gjinore (535 pjesëmarrës); e financave publike (344 pjesëmarrës); e prokurimit publik (971); e teknologjisë (705 pjesëmarrës); e zhvillimit personal (587 pjesëmarrës); e menaxhimit të organizatës (2403 pjesëmarrës); lidhshmërisë 250 pjesëmarrës.
⁸ Vlerësimi i fundit i indikatorit 6 d "Shkalla në të cilën sistemi i trajnimit të nëpunësve civilë është funksional dhe zbatohet në praktikë (Indikator i SIGMA-s) është ai i vitit 2017 nga SIGMA, ku shënonte nivelin 3, më shumë në linkun <http://www.sigmaweb.org/publications/monitoring-reports.htm>

Të gjithë masat e ndërmarra në funksion të mirëmenaxhimit të burimeve njerëzore, kanë në krye të tyre, ndërmarrjen më të rëndësishme sa i takon Reformimit të Shërbimit Civil dhe Administratës Publike që është **reformimi i strukturës së pagave**. Përmes skemave të reja, shkallëve të pagës dhe kalkulimeve, ajo që synohet është aplikimi i Parimit “Pagë e njëjtë për punë të njëjtë”. Puna për reformimin e sistemit të pagave ka filluar që në 2019 me hartimin e letrës së politikave e cila ka marrë versionin e saj përfundimtar si projekt propozim në 2020. Për shkak të situatës në vend, periudhës post tërmet dhe pandemisë globale, ishte i pamundur finalizimi dhe miratimi i kësaj letrë politikash në 2020. Megjithatë, për të mundur një paketë të plotë me të gjithë elementet e duhur për realizimin me sukses të kësaj reforme, DAP do të fillojë nga puna në 2021 për kalkulimin e impaktit financiar që kjo reformë do të ketë në buxhetin e shtetit. Kështu një propozim i një rëndësie të tillë do të paraqitet Këshillit të Ministrave me të gjithë komponentët e tij. Kjo reformë jo vetëm që do të rrisë motivimin e nëpunësve publikë aktualë por do ta bëjë administratën publike me tërheqëse për profesionistë të kualifikuar⁹.

⁹ Indikator 7 a “Tarimi i sistemit të pagave dhe arritja e raportit 22.1 në vitin 2020 ndërmjet pagës maksimale dhe minimale” nuk ka ndryshuar që nga viti 2017 duke shënuar vlerën 8.9 . Target: 22.1. Ky indikator nuk është arritur. Indikator 7 b “Rritja e variacionit/ numrit të pozicioneve në skemën e pagave bazuar në përshkrimin e punës” do të jetë e mundur të realizohet me përfundimin e reformimit të sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e pozicionit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme. Indikator 7 c “Shkalla në të cilën sistemi i shpërblimit të nëpunësve civilë është i drejtë dhe transparent dhe zbatohet në praktikë (Indikator i SIGMA-s)”, shënon vlerën 3 në matjen e tij më të fundit, realizuar nga SIGMA në 2017. Linku i SIGMA për të aksesuar raportet e tyre të vlerësimit për vendin: <http://www.sigmaweb.org/publications/monitoring-reports.htm>

Shtylla IV – Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja

Politikat nën këtë shtyllë synojnë rishikimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut dhe thjeshtimin e tyre duke përfshirë zgjidhje të Teknologjisë së Informacionit si dhe duke marrë në konsideratë zbatimin e Kodit të ri të Procedurave Administrative, në drejtim të rritjes së përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë në kryerjen e funksioneve të tyre.

Objektivat e planifikuara në kuadër të Shtyllës IV synojnë:




Procedura të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin



Zhvillimin e një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e efikasitetit duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit;




Rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë;




Rritjen e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion

Shtylla IV “Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja” parashikon realizimin e 30 nën-aktivite-
teve, nga të cilat kanë filluar të zbatohen 27 nën-aktivitete (ose 90%), e prej këtyre të fundit 8
janë realizuar plotësisht ose 30%.


**Grafiku 22 - Progresi për qëllimin politik:
Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja**




**Grafiku 23 - Statusi i realizimit të qëllimit politik:
Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja**



Grafiku 24 - Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 25 - Statusi i realizimit të nën-aktiviteteve sipas Objektivave



Shqipëria ka filluar procesin e transformimit të shërbimeve publike prej kohësh dhe beson fuqimisht në ndryshimin e mendjes së qytetarëve në lidhje me këtë formë të re të pashmangshme të komunikimit me institucionet shtetërore. Për sa i përket ndikimit, kjo përkthehet në një ulje të kostove të marrjes së shërbimeve, lehtësim të procedurave burokratike, ulje të kohës për të marrë shërbimet, por edhe përmirësim të transparencës dhe të cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Qeveria shqiptare, si promovuese e shndërrimit të shërbimeve offline në shërbime online, e shndërroi platformën qeveritare e-Albania në një histori suksesi, arriti të ndërtojë një imazh serioz të shtetit dhe të rivendoste besimin e qytetarëve në institucionet publike.

e-Albania vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare, duke shërbyer kështu si një pikë hyrëse për qytetarët 24/7 dhe është e lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit që është arkitektura themelore që lejon ndërveprimin midis 55 sistemeve elektronike të institucioneve publike.

E gjendur në një valë të gjatë të procesit të dixhitalizimit, i cili ka filluar që nga viti 2013, Shqipëria aktualisht po kalon një nga proceset më të rëndësishme të dixhitalizimit dhe transformimit të shërbimeve publike në historinë e saj. Qeveria është e vendosur t'i shndërrojë institucionet në shërbim të plotë për qytetarët dhe ka përqendruar plotësisht vëmendjen e saj në shndërrimin e sporteve fizike në ato online.

Nga 1 janari i vitit 2020, ka filluar një proces i ri për shërbimet publike, ai i ofrimit të aplikimeve për shërbime publike për qytetarët dhe bizneset vetëm online. Qytetarët dhe bizneset aplikojnë vetëm përmes platformës e-Albania dhe janë punonjësit e administratës publike ata që mbledhin të gjitha dokumentet shtetërore të shërbimeve. Të gjitha të dhënat dhe dokumentet shtetërore tani përdoren dhe ripërdoren, duke i çliruar qytetarët nga barra e grumbullimit të tyre fizikisht në letër në sportelet e shtetit.

Që nga 1 janari 2020, të gjitha dokumentet shtetërore që më parë ishin kërkuar të mbledheshin nga qytetarët nuk u kërkojnë më atyre. Është punonjësi ai që siguron këto dokumente në emër të qytetarit, ose duke shkarkuar versionin e tyre të vulosur elektronikisht nga platforma e-Albania ose duke i kërkuar ata tek institucioni ofrues i këtyre dokumenteve përmes një sistemi elektronik të dedikuar që AKSHI ka ndërtuar vetëm për këtë qëllim.

Në këtë kuadër, të gjitha shërbimet elektronike, aplikimet e të cilave ofrohen vetëm online nga 1 janari 2020 janë ndryshuar plotësisht në formatin e tyre duke e ndarë listën e dokumenteve të shoqëruar në:

— — Dokumentet të cilat thjeshtë janë të listuara por nuk janë përgjegjësia e qytetarit për t'u siguruar;

— — Dokumentet të cilat përfshijnë vetëm vetëdeklarime dhe dokumente private që duhet të sigurohen nga vetë qytetari.

Është krijuar një sistem i veçantë për bashkëveprimin e të gjitha institucioneve (Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik), me qëllim shkëmbimin elektronikisht të të gjitha dokumenteve shoqëruese të dosjes së qytetarit, me nënshkrim elektronik. Kjo zvogëlon barrën për qytetarët dhe bizneset dhe dokumentet e vetme që duhet të ngarkojnë janë vetëdeklarimet dhe dokumentet që ata marrin nga subjektet private.

Përmes këtij sistemi, punonjësit kërkojnë dokumentet e nevojshme nga institucionet që i gje-

nerojnë ato, dhe këto të fundit përpunojnë kërkesën për dokumentin në fjalë. Pasi nënshkruhet në mënyrë elektronike nga titullari i institucionit ose punonjësit me të drejtë firme, dokumenti i dërgohet përsëri përmes sistemit punonjësit që ka bërë kërkesën. Në fund, zyrtari i administratës publike plotëson dosjen e aplikantit me dokumente administrative të lëshuara nga institucionet shtetërore, dhe më pas i ofron qytetarit shërbimin publik të kërkuar.

Për të reduktuar sa më shumë burokracitë e lidhura me shërbimet publike, është zhvilluar një proces deregulimi me qëllim:

- **Uljen e numrit të dokumenteve shoqëruese që u kërkojnë qytetarëve/bizneseve;**
- **Ri-inxhinierizimin e gjithë procesit të ofrimit të tyre, me qëllim uljen e hapave të nevojshëm për marrjen e shërbimit, dixhitalizimin e proceseve të brendshme duke zvogëluar burokracitë, kostot dhe kohën për qytetarët.**


Që procesi të jetë sa më transparent, pasi aplikon online, qytetari pajiset me një numër unik që i mundëson atij të gjurmtojë statusin e aplikimit të tij. Ai ka gjithashtu mundësinë që të ngarkojë dokumente shtesë përmes numrit të tyre unik të aplikimit nëse është e nevojshme ose kërkohe më vonë nga institucioni.

Qeverisja dixhitale është një tregues i rëndësishëm i mirëqënies së qytetarëve të një vendi. Kjo sepse qytetarët marrin shërbime të automatizuara nga sektori publik, që minimizojnë korrupsionin apo abuzimet e zyrtarëve dhe e kthejnë administratën në efçente. Bota perëndimore, pra shtetet ligjore dhe të mirëqeverisura, nuk mund të kuptohen pa qeverisjen dixhitale dhe jo rastësisht vendet më të zhvilluara të botës janë vendet që kanë qeverisjen dixhitale më të avancuar.

Raportet e organizatave më prestigjioze në botë, nga OBK, OECD, Departamenti i Amerikan Shtetit dhe ai i BE për vitin 2020 i kanë dhënë Shqipërisë notën maksimale në qeverisjen dixhitale si një tregues i rëndësishëm i mirëqënies së qytetarëve të një vendi.

Portali, i cili ofron më shumë se 1000 shërbime elektronike është i lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit që është arkitektura themelore që lejon ndërveprimin midis 55 sistemeve elektronike të institucioneve publike.

Gjatë vitit 2020 janë shtuar në portal 420 shërbime të reja duke e rritur totalin e tyre me 70 herë krahasuar me vitin 2013.




Grafiku 26 - Numri i shërbimeve elektronike niveli 3-4 (sipas UNPAN 2014)

Mbi 4 milionë dokumente me vulë elektronike janë përfituar lehtësisht nga qytetarët dhe bizneset gjatë vitit 2020 dhe 758 mijë përdorues të regjistruar gjatë vitit 2020 dhe shumë të tjerë, përfitojnë shërbimet elektronike të publikuara në portalin e-Albania duke shmangur kështu korrupsionin dhe vonesat.

Gjithashtu gjatë 2020 është rritur numri të transaksioneve të kryera në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit ku numërohen mbi 144 milionë transaksione, shifër e cila është 200 herë më e lartë se numri i transaksioneve të kryera gjatë vitit 2013.

Numri i përdoruesve të regjistruar në portal ka pësuar një rritje të lartë dhe është 1,781,674 ose 36 herë më i lartë se 2013. Vetëm gjatë vitit 2020 janë regjistruar në portalin qeveritar e-Albania 758,735 përdorues të rinj.



Grafiku 27 - Numri i përdoruesve të rinj, 2013 - 2020

Këto rritje të ndjeshme të numrit të përdoruesve, shërbimeve dhe transaksioneve gjatë 2020, kanë ardhur si rezultat i faktit që përmes portalit u ofruan e-Shërbimet në ndihmë të situatës emergjente të krijuar për shkak të Covid-19. Për të reduktuar përhapjen e COVID-19, gjatë situatës emergjente të pandemisë, të gjithë qytetarët të cilët duhet të dilnin nga shtëpia mund të pajiseshin me një leje të veçantë ditore nëpërmjet portalit e-Albania. Ndërkohë u ofruan dhe zgjidhje alternative për ata qytetarë të cilët nuk kishin akses në internet apo për qytetarët e huaj të ndodhur në Shqipëri, të cilët aplikuan nëpërmjet një mesazhi/SMS.

Në drejtim të lehtësimit të aksesit për qytetarët dhe bizneset në shërbimet elektronike, u ndërmorën disa iniciativa të rëndësishme si vula dixhitale, moduli i administratës publike, i cili shërben për nxjerrjen e dokumenteve administrative për qytetarin dhe Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik, kjo një lehtësi tjetër që ofron portali e-Albania ku tashmë, nuk është më barrë e qytetarit të paraqitet nga një zyrë në tjetrën për të mbledhur të gjitha dokumentet e nevojshme në plotësimin e dosjes së aplikimit për një shërbim publik, por është punonjësi i administratës publike ai që i siguron ato nëpërmjet portalit. Në këtë kuadër, trajnimi i punonjësve të administratës publike është i vazhdueshëm me qëllim aftësimin e tyre për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe transparente për qytetarët.


Kështu gjatë 2020, për këtë modul janë trajnuar 2300 punonjës të administratës. Deri në fund të vitit 2020 janë 46 dokumente me vulë elektronike që ofrohen në modul për nëpunësit e administratës publike që merren me procedurat e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve me qëllim përmirësimin e disponueshmërisë, cilësisë dhe transparencës së shërbimeve publike

si dhe reduktimin e kohës së zbatimit të procedurave dhe kostove të administratës publike. Falë këtij shërbimi mbi 9.5 milionë dokumente me vulë elektronike janë përfituar lehtësisht nga qytetarët dhe bizneset, duke shmangur përfundimisht korrupsionin dhe vonesat.

Për të marrë feedback të vazhdueshëm nga qytetarët dhe bizneset që përdorin shërbimet elektronike të portalit e-albania është implementuar mekanizimi i vlerësimit me yje në përfundim të aplikimit apo marrjes së shërbimeve elektronike. Nëpërmjet këtij funksionaliteti, përdoruesit mund të japin vlerësimin e tyre me notën nga 1 – 10 yje si dhe të shkruajnë një koment narrativ për të shpjeguar më gjerësisht eksperiencën e tyre në portal. Që nga implementimi i këtij mekanizmi, janë dhënë mbi 814,184 vlerësime nga qytetarët dhe bizneset ku vlerësimi mesatar për shërbimet elektronike të përdorura është 9.2¹².

Monitorimi i cilësisë së shërbimit ka vijuar përmes kryerjes së sondazheve të drejtpërdrejta dhe matjen e kohës së pritjes dhe kohës së aplikimit. Matja e kënaqësisë qytetare është kryer në sportelet pritëse në Qendrat e Integruara Tiranë 1 dhe 2, Kavajë, Shkodër, Gjirokastrë, Divjakë, Lushnje, Krujë, Librazhd dhe Fier ku rezulton se pjesa më e madhe e qytetarëve janë të kënaqur me shërbimin e marrë pranë sporteleve të aplikimit³. Nga analizimi i të dhënave në Qendrat e Integruara ADISA, vihet re se niveli i kënaqësisë qytetare është i lartë. Të gjithë qytetarët shprehen se janë “Të kënaqur” ose “Shumë të kënaqur”, dhe vetëm në Zyrën Rajonale Tirana 1, 2% e të intervistuarave shprehen se janë “Disi të kënaqur”. Më poshtë paraqitja grafike e nivelit të kënaqësisë qytetare në sportelet pritëse ADISA sipas sondazheve të drejtpërdrejta:

Grafiku 28 - Niveli i kënaqësisë qytetare sipas sondazheve të drejtpërdrejta



¹ Indikator 9a “Sisteme të përmirësuara të IT-së për ofrimin e shërbimeve”, vlera më e fundit është 28 për vitin 2019. Target për vitin 2020 është 8 agjenci, target i arritur që në 2019 (<https://akshi.gov.al/axhenda-dixhitale/>).

² Indikator 9b “Shkalla në të cilën janë të zbatueshme parakushtet politike dhe administrative për ofrimin e shërbimeve elektronike” (Indikator i SIGMA-s), shënon vlerën 5 në matjen e tij më të fundit, realizuar nga SIGMA në 2017. Linku i SIGMA për të aksesuar raportet e tyre të vlerësimit për vendin: <http://www.sigmaxweb.org/publications/monitoring-reports.htm>

³ Indikator 8a “Numri i shërbimeve me procedura të thjeshtësuara për ofrimin e tyre”. Vlera më e fundit është 300 për vitin 2020. Arritjet kundrejt nivelit të synuar për vitin 2020 janë për pasojë në nivelin %100.



Vlera 2020



INDIKATORI 8B


NIVELI (%) I KËNAQSHMËRISË PUBLIKE KUNDREJT CILËSISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

Indikatori 8b. i cili mat nivelin e kënaqshmërisë mbi cilësinë e ofrimit të shërbimeve ka shënuar tendencë në rritje. Duke patur parasysh analizat e mësipërme për matjen e kënaqësisë qytetare në sportelet pritëse në Qendrat e Integruara ADISA Tiranë 1 dhe 2, Kavajë, Shkodër, Gjirokastrë, Divjakë, Lushnjë, Krujë, Librazhd dhe Fier, rezulton se ky indikator ka progres krahasuar me periudhat para hapjes së Qendrave të Integruara ADISA. Raportet mbi monitorimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara dokumentojnë vlerësimin e publikut për ofrimet e shërbimeve në nivele të larta. Tendencë në rritje e përqindjes së kënaqshmërisë së qytetarit është rritur në mënyrë progresive nga viti 2016 deri në vitin 2020. Arritjet kundrejt nivelit të synuar për vitin 2020 janë realizuar falë masave të marra në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit dhe reduktimin e kohës së pritjes në sportele⁴.

Një nga elementët që siguron cilësi të lartë të shërbimeve është padyshim profesionalizmi i administratës publike. Në drejtim të krijimit të kushteve dhe procedurave për zbatimin me transparencë dhe objektivitet të promovimit në karrierë në shërbimin civil janë identifikuar në mënyrë periodike nevojat për trajnim nëpërmjet organizimit të procesit të Analizës së Nevojave për Trajnim (ANT).

Tashmë është hartuar dhe miratuar metodologjia e vlerësimit të nevojave. Vlerësimi i nevojave gjithëpërfshirëse për trajnim ka filluar në vitin 2018 dhe vlerësimi i radhës u zhvillua në dhjetor 2020.

Përveç vlerësimit të përgjithshëm të nevojave, është zhvilluar edhe vlerësimi specifik për trajnim në katër fusha:



⁴ Indikatori 8c "Shkalla në të cilën politikat për ofrimin e shërbimeve të fokusuar tek qytetari janë miratuar dhe zbatuar në praktikë" (indikatori i SIGMA-s) shënon vlerën 3 në matjen e tij më të fundit, realizuar nga SIGMA në 2017. Linku i SIGMA për të aksesuar raportet e tyre të vlerësimit për vendin: <http://www.sigmaweb.org/publications/monitoring-reports.htm>

Sesione coaching janë ofruar për trajnerët e ASPA gjatë vitit 2020 në kuadër të rritjes së kapaciteteve duke ofruar **online coaching** individual për të gjithë nëpunësit pjesëmarrës në trajnime. Për këtë qëllim janë identifikuar trajnerët të cilët mund të zhvillojnë coaching dhe mentoring të cilët janë të certifikuar për t'i zhvilluar ato. Aktualisht kjo mundësi i është propozuar Trupës së Nivelit të lartë Drejtues me të cilët ASPA pilotoi programin e trajnimit.

Tashmë ka përfunduar pilotimi i programit të trajnimit me anëtarët ekzistues të TND-së, program i cili është i detyrueshëm për frekuentim në masën 70%. Pas masave dhe punës intensive të zhvilluar për përdorimin e platformave dhe përshtatjen e programit online, trajnimet rifilluan për këtë kategori dhe kohëzgjatja e parashikuar për modulet është ruajtur dhe në formatin e trajnimit online. Përveç moduleve të parashikuara në program, këtij target grupi iu ofrua edhe trajnimi "Statistika si mjet për të ndihmuar vendimmarrjen dhe për të argumentuar vendimet e marra". Sesionet e trajnimit kanë përfunduar me sukses në tetor të vitit 2020.

Në kuadër të zbatimit të programit "Administrata që duam" ka vijuar zhvillimi i trajnimeve në temat e parashikuara në këtë platformë, duke iu përgjigjur nevojave për trajnim. Dy drejtimet kryesore ishin:

— — Aftësimi në management skills: të lidhura me parashikimet e programit - trajnimi për lidhshëm, menaxhim strategjik, menaxhim projektsh dhe programesh, management skills dhe hartim politikash. ASPA gjatë vitit 2020 ka trajnuar 3273 pjesëmarrës për ciklin e punës në administratën publike⁵.

— — Ofrimi i Paketës bazë online: në kuadër të pilotimit të programit për TND- janë vënë në dispozicion online materiale trajnuese dhe janë hapur klasa online në kuadër të pilotimit të programit të trajnimit për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues, ku pjesëmarrësit kanë marrë online materiale për të gjitha modulet e planifikuara. Kjo është realizuar edhe në kuadër të zhvillimit të kurseve online ku për çdo grup krijohet klasa virtuale dhe çdo pjesëmarrës ka akses në materialet sipas moduleve.

Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion është gjithashtu një objektiv i rëndësishëm nën këtë shtyllë⁶.

Zyra e Komisionerit ka vijuar punën lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji kryhet nëpërmjet monitorimit të elementëve kryesorë si (i) numri i Autoriteteve Publike që kanë hartuar dhe/ose përditësuar programet e transparencës, (ii) numri i Autoriteteve Publike që kanë caktuar koordinatore për të drejtën e informimit, (iii) përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, shqyrtimit të ankesave, kryerjes së hetimeve administrative, zhvillimit të seancave dëgjimore si dhe dhënies së vendimeve dhe rekomandimeve⁷.

Për të ndjekur këtë proces gjatë vitit 2020 u krijuan dy instrumente të reja për matjen e transparencës proaktive:

— — Instrumenti i parë: "Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", u zhvillua gjatë muajve nëntor-dhjetor 2020. Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 4 treguesve kryesorë të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të

⁵ Në fushat: planifikim strategjik; politikëbërje; statistikë; mikro-makroekonomi; advokim; menaxhim i projektit; hartim dhe monitorim buxheti; teknikë legjislativ; prokurim publik; audit dhe kontroll financiar; koncesione; analizë rregullatore e impaktit; vendimarrje dhe investime publike.

⁶ Indikator 10 a "Shkalla në të cilën kuadri ligjor për administrimin e mirë është miratuar dhe zbatuar në praktikë (Indikator i SIGMA-s)". Vlera e fundit e indikatorit 10 a është ajo e vlerësimit të SIGMA në vitin 2017 ku shkalla në të cilën kuadri ligjor për administrimin e mirë është miratuar dhe zbatuar në praktikë ka qenë 3 duke shënuar një rritje krahasuar me vlerësimin e vitit 2015, niveli i të cilit ishte 2.

⁷ Informacion më i detajuar mund të gjendet në aneksin e ecurisë së Planit të Aktiviteteve 2022-2018, objektiv 10.

[transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore.](#)

— — Instrumenti i dytë: “Indeksi i Transparencës Proaktive i Institucioneve Qendrore dhe të Varësisë” u zhvillua gjatë muajit dhjetor 2020. Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 5 treguesve kryesorë të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të [transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë](#).

Zhvillime pozitive gjatë kësaj periudhe raportimi ka patur veçanërisht në lidhje me përmirësimin e përmbajtjes së programeve të transparencës së institucioneve të pavarura dhe atyre qendrore.


Me qëllim garantimin e njohjes me informacion publik dhe vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, gjatë vitit 2020 Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale është angazhuar intensivisht në rishikimin e Programit model të Transparencës për Autoritetet Publike.

Rishikimi i Programit të Transparencës u diktua dhe si pasojë e problematikave të ndeshura gjatë 5 vjeçarit të kaluar për të përmbushur më së miri nevojat e qytetarëve, shoqërisë civile dhe vetë autoriteteve publike për të pasur një program model, i cili të jetë sa më i qartë dhe lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë.

Për këtë arsye, në hartimin e modelit të ri të programit të transparencës Zyra e Komisionerit u fokusua në specifikimin e dokumentacionit konkret që i korrespondon kategorisë specifike të informacionit dhe në paraqitjen sa më miqësore të tij nga ana vizuale.

PROGRAMI I TRANSPARENCËS		
RRETH AUTORITETIT	KUADRI LIGJOR RREGULLATOR	E DREJTA PËR T’U INFORMUAR DHE ANKUAR
MEKANIZMAT KONTROLLUES DHE MONITORUES QE VEPROJNE MBI AP	INFORMACIONE MBI BUXHETIN DHE TË DHËNAT FINANCIARE TE AP	INFORMACION PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT / PROCEDURAT KONKURRUESE TË KONCESIONIT / PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT
SHËRBIMET QË OFROHEN NGA AP	PROCEDURA/MEKANIZMA PËR TË DHËNË MENDIM LIDHUR ME PROCESIN E HARTIMIT TË AKTIVE LIGJORE/ NËNLIGJORE, POLITIKAVE PUBLIKE DHE USHTRIMIN E FUNKSIONEVE TE AP	SISTEMI I MBROJTJES SË DOKUMENTACIONIT, LLOJET DHE FORMAT E DOKUMENTEVE
RREGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE	NDIHMA SHOQËRORE / SUBVENCIONE TË DHËNA NGA AP	INFORMACIONE / DOKUMENTA QË KËRKOHEN MË SHPESH DHE ATO QË GJYKOHEN TË DOBISHME PËR PUBLIKIM NGA AP

Zhvillim pozitiv është evidentuar në lidhje me masat e marra për vënien në funksion të plotë të regjistrin qendror të kërkesave dhe përgjigjeve. Numri i autoriteteve publike të cilët kanë të instaluar regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve është pothuajse dyfishuar gjatë vitit 2020.



Grafiku 29 - Numri i autoriteteve publike që kanë instaluar Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2018-2020

Nga monitorimi i autoriteteve publike ka rezultuar se 239 autoritete kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare programin e transparencës; 236 kanë publikuar kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit dhe 137 kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”⁸.

Aspekt tejet i rëndësishëm është dhe trajtimi i ankesave të cilat i drejtohen Zyrës së Komisionerit mbi refuzim për dhënie informacioni. Gjatë vitit 2020 janë administruar 715 ankesa me objekt “Refuzim dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare” ndaj Autoriteteve Publike por me iniciimin e procesit të hetimit administrativ dhe ndërhyrjen e Zyrës së Komisionerit, Autoritet Publike kanë proceduar me dhënien e informacionit për 472 ankesa.



Vlera 2020

715

INDIKATORI 11A


NUMRI I ANKESAVE TË PARAQITURA ÇDO VIT PRANË KOMISIONERIT PËRGJEGJËS PËR LIRINË E INFORMIMIT

Për vitin 2020, **indikatori 11a** i cili paraqet numrin e ankesave, ka pasur tendencë në ulje. Sikurse është parashikuar dhe në pasaportën e indikatorëve nga 684 ankesa të shqyrtuara në vitin 2016, në vitin 2017 janë shqyrtuar 560 ankesa, në vitin 2018 janë shqyrtuar 820 ankesa, në vitin 2019 janë shqyrtuar 786 ankesa dhe në vitin 2020 janë shqyrtuar 715.


Për sa i përket pjesës së indikatorit lidhur me numrin e sanksioneve të aplikuara nga ana e Komisionerit në raport me numrin e inspektimeve të kryera pranë autoriteteve publike, sikurse parashikohet në pasaportën e indikatorëve, ky raport për vitin 2020 është 0.049%, duke qenë pothuaj në të njëjtin nivel me 2019.

Në lidhje me veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë 2020 janë adresuar në total 256 rekomandime drejtuar organeve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore.

Grafiku 30 - Statusi i Rekomandimeve



Siç rezulton nga të dhënat e mësipërme, numri i rekomandimeve të regjistruara për vitin 2020 është 256 por 49 prej tyre janë në proces që do të thotë se për këto rekomandime ende nuk kanë kaluar afatet procedurale për të konsideruar nëse janë pranuar apo refuzuar, zbatuar apo pa zbatuar, me apo pa përgjigje, duke qënë se janë dërguar në fund të vitit 2020 apo në fillim të vitit 2021 për inspektime të kryera në 2020. Në këto kushte, për të mundësuar raportimin e të dhënave dhe gjenerimin e indikatorit real, përllogaritja e indikatorit do të realizohet në dy forma: (1) mbi bazën e rekomandimeve faktike (200 rekomandime) të cilët u janë dërguar subjekteve përkatëse dhe janë ezauruar afatet proceduale për të konkluduar lidhur me pranimin apo zbatimin e tyre nga institucionet, (2) mbi bazën e totalit të rekomandimeve të adresuara gjatë vitit 2020 256 rekomandime).



Në përfundim, nisur nga analiza e statistikave të mësipërme, për vitin 2020 evidentohet se ka një rënie të përqindjes së rekomandimeve të pranuar në tërësi nga institucionet e Administratës Publike, por ka një rritje në përqindjen e rekomandimeve të zbatuara. Nga numri i rekomandimeve të adresuara në total (256), rezulton se 142 prej tyre janë pranuar, 68 prej rekomandimeve të pranuar kanë gjetur zbatim të plotë dhe 42 prej rekomandimeve kanë gjetur zbatim të pjesshëm. Pra, referuar **indikatorit 11b**: raportit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht me rekomandimet e pranuar, ai është në nivelin 48 % ndërsa për ato të realizuara pjesërisht në nivelin 30 %. Ndërkohë, lidhur me rekomandimet pa përgjigje rezulton se për vitin 2020 janë 34 rekomandime pa përgjigje. Pra, referuar raportit midis rekomandimeve pa përgjigje dhe rekomandimeve të adresuara në total nga Avokati i Popullit, rezulton se 17 % e tyre nuk kanë përgjigje. Krahasimisht me vitin 2019 ku vlera e indikatorit shënonte 25% dhe 66%.⁹

⁹ Ky indikator përbëhet nga tre nën indikatorë nga të cilët një është arritur dhe dy nuk janë arritur. Ky indikator nuk është arritur.

VLERËSIMI I ARRITJEVE KRYESORE DUKE PËRDORUR TREGUESIT

Pasaporta e indikatorëve është dokumenti bazë i cili është hartuar me mbështetje të SIGMA dhe në bashkëpunim të plotë me institucionet përgjegjëse dhe shërben për matjen e treguesve të nivelit të rezultatit të SNRAP monitorimi i të cilit bazohet në përshkrimin metodologjik të matjes të të gjithë treguesve.



**TARGET I
ARRITUR
12**



**VLERËSOHEN
ÇDO DY VJET
7**



**NËN VLERËN
E SYNUAR
9**

Nga totali i 28 indikatorëve, pjesë e pasaportës së treguesve në nivel rezultati, 12 indikatorë janë arritur plotësisht. Indikatorët e arritur janë:

- **—** trajnimi i stafit të politikëbërjes të ML-së i trajnuar për çështjet e planifikimit strategjik;
- **—** rritja e cilësisë së analizës së vlerësimit të ndikimit dhe vlerësimi i zbatimit për aktet ligjore të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara;
- **—** rritja e përqindjes së raporteve të monitorimit dhe vlerësimit për strategji të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara në baza vjetore;
- **—** ulja e numrit të akteve ligjore të ndryshuara brenda vitit të parë të miratimit;
- **—** shtimi i numrit të konsultimeve publike/prezantimeve të organizuara për të diskutuar raportet e monitorimit dhe vlerësimit;
- **—** shtimi i numrit të shërbimeve të qeverisë qendrore me ndërveprim të përmirësuar në zyrat e pritjes;
- **—** rritja e numrit mesatar të pjesëmarrësve nga jashtë dhe brenda shërbimit civil që marrin pjesë në një proces rekrutimi (indikator 6 b1 dhe 6 b2);
- **—** ulja e numrit të ankesave që kanë të bëjnë me rekrutimin në shërbimin civil, të pranuar nga gjykata;
- **—** shtimi i numrit të shërbimeve me procedura të thjeshtuara për ofrimin e tyre;
- **—** rritja e nivelit të kënaqshmërisë publike kundrejt cilësisë së ofrimit të shërbimeve;
- **—** përmirësimi i sistemeve të IT-së për ofrimin e shërbimeve;
- **—** numri i ankesave të paraqitura çdo vit pranë Komisionerit përgjegjës përgjegjës për lirinë e informimit.

SIGMA asiston në matjen e 7 prej indikatorëve pjesë e pasaportës së indikatorëve. Këto indikatorë vlerësohen sipas afateve kohore të përcaktuara në metodologji dhe maten rregullisht nga SIGMA për të parë impaktin e tyre në terma afatgjatë. Vlerësimi i fundit i bërë për këto indikatorë është ai i vitit 2017 ndërkohë që pritet publikimi i raportit të SIGMA mbi vlerësimin e kryer së fundmi [SIGMA](#). Nga ana tjetër gjatë procesit të monitorimit janë evidentuar 9 indikatorë të cilët nuk janë arritur: nga këto 5 indikatorë shënojnë vlera në rritje nga viti 2019 por duhen akoma përpjekje për të arritur targetin e synuar, 2 prej tyre shënojnë trend konstant ndërsa 2 të tjerë tregojnë një trend zbritës. Disa nga problematikat kryesore të cilat lidhen me mosarritjen e indikatorëve janë evidentuar më në detaj gjatë analizës së kryer për secilin indikator.


Pasaporta e indikatorëve do të rishikohet për të analizuar progresin, problematikat dhe vlerësuar mundësinë e ndryshimeve dhe afateve kohore bazuar në argumentimin e çdo propozimi të mundshëm nga institucionet e përfshira në zbatimin e SNRAP.

KOMUNIKIMI I AKTIVITETEVE

Një element shumë i rëndësishëm i cili ndikon në progresin e mëtijshëm të strategjisë është gjithashtu komunikimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi masat që ndërmerren si dhe rezultatet e arritura për të qenë sa më të prekshme dhe transparente për të gjithë. Kështu duke publikuar progresin e reformave të ndërmarra synohet për të patur një impakt më të konsoliduar ku DAP bashkërendon me institucionet gjithnjë e më shumë për organizimin e eventeve të ndryshme me qëllim prezantimin e arritjeve në fushë e Reformës në Administratën Publike. Aktivitetet kryesore në drejtim të promovimit të rezultateve dhe impaktin e reformës gjatë vitit 2020 kanë qenë:



OECD/SIGMA finalizon raportin “Government at a Glance: Western Balkanas”



Takimi virtual, i mbajtur në 8 Korrik 2020, mblo-dhi së bashku përfaqësues të nivelit ministror nga gjashtë vende të rajonit për të diskutuar mbi rapor-tin rajonal “Galance Report” hartuar nga [OECD/SIGMA](#). Në këtë takim u prezantuan gjetjet dhe mësimet kryesore për menaxhimin e krizës në vazhdim (COVID-19) si dhe u disku-tua mbi përpjekjet dhe masat për të avancuar akoma dhe më tej reformimin e administratës publike gjatë pandemisë.

Publikimi paraqet informacion mbi qeverisjen publike në ra-jonin e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Bosnje dhe Hercego-vinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut dhe Serbi), duke i kra-hasuar ato me vendet e OECD dhe OECD - BE.

Ky botim (i parë rajonal) përmban 40 indikatorë mbi financat publike, punësimin publik, qendrën e qeverisjes, praktikat dhe procedurat e buxhetimit, menaxhimin e burimeve njerëzore, prokurimin publik, qeverisjen dixhitale dhe shërbimin ndaj qytetarëve. Këto tregues ofrojnë standarde të rëndësishme për sistemet, praktikat dhe performancën e administratës publike.



Inaugurimi i Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike në Lushnje



Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara ADISA, inauguroi në Janar të vitit 2020 Qendrën e saj të shtatë të Integruar në qytetin e Lushnjës, ku do t'u shërbejë qytetarëve në kushte dhe standarde bashkëkohore.

Qendra e Integruar ADISA në qytetin e Lushnjës, do t'ju mundësojë qytetarëve ofrimin e 472 shërbimeve publike në 14 sportele. Qendra e ADISA në Lushnje ofron rreth 68 shërbime Vendore të Bashkisë dhe shërben mesatarisht për 200 qytetarë në ditë.

Kjo Qendër ruan të gjitha standardet evropiane për ofrimin e shërbimeve publike dhe mundëson kështu ambiente bashkëkohore që ofrojnë akses për të gjithë qytetarët në kushtet më të mira.




Transparenca

Në drejtim të sensibilizimit të publikut mbi të drejtën e informimit, Zyra e Komisionerit gjatë vitit 2020, ka nisur publikimin mujor të [Newsletter "E drejta për Informim"](#). Ky newsletter i cili i përcjell lexuesit çdo muaj zhvillimet më të fundit në të drejtën e informimit, është konceptuar si një urë e re komunikimi midis Zyrës së Komisionerit, Koordinatorëve për të Drejtën e Informimit dhe qytetarëve të interesuar për të mësuar më shumë rreth të drejtës së tyre për të pasur akses në informacionin publik



ONLINE RECRUITMENT TO THE CIVIL SERVICE
IN ALBANIA
AS A RESPONSE TO THE COVID-19 CRISIS

REKRUTIMI ONLINE NË SHQIPËRI




Masat e ndërmarra në vend për adresimin e sfidës së Covid dhe zhvillimin e procedurave online të rekrutimit në shërbimin civil u konsideruan si një praktikë e mirë në rajon e më gjerë dhe u prezantuan si të tilla në takime me përfaqësues të administratave të Ballkanit Perëndimor dhe struktura të tjera ndërkombëtare.

Kështu me mbështetjen e Këshillit të Evropës u publikua një [video](#) informuese mbi arritjet kryesore të vendit në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore me platformën administrata.al dhe rekrutimin online. Prezantimi u bë nga znj. Albana Koçiu, Drejtor i DAP dhe njëkohësisht anëtare e Byrosë së Komitetit Evropian për Demokraci dhe Qeverisje (CDDG).

Gjithashtu, në bashkëpunim me SIGMA/OECD u përgatit një [paper mbi zhvillimin e rekrutimit në shërbimin civil plotësisht online](#) në Shqipëri, paper i cili u prezantua në një takim virtual të organizuar nga SIGMA/OECD në përgjigje të kërkesave për të diskutuar më në detaje mbi praktikën e rekrutimit online të aplikuar në Shqipëri.

Gjatë prezantimit, Znj. Koçiu ndau me kolegët nga rajoni dhe vendet e BE, hapat e ndërmarë gjatë këtyre viteve në vend drejt digitalizimit dhe përmirësimit të procesit të rekrutimit, çka siguroi dhe një bazë solide për realizimin e transformimit të këtyre procedurave tërësisht online.



RESPA AWARDS ÇMIMET PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE

Shqipëria fitoi dy çmime të rëndësishme në ceremoninë e [“Public Administration Awards”](#) të organizuar nga Respa dhe OECD/SIGMA. gjatë vitit 2020

Në fushën e ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve në administratën publike ASPA me aplikimin “Së bashku pavarësisht se jemi larg – Një histori bashkëpunimi gjatë pandemisë COVID-19” është vlerësuar me çmimin “Public Administration Award 2020”, në kategorinë e-Learning. Eksperienca e Shqipërisë në ofrimin e trajnimeve përmes metodave e-learning u referua si një rast pozitiv. ASPA është përshtatur me shpejtësi gjatë kohës së pandemisë duke zhvilluar të gjitha kurset në mjedis digjital.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është vlerësuar me çmimin për qeverisjen digjitale për zbatimin e praktikave, iniciativave, shërbimeve online dhe masave efikase për përballimin e krizës së derivuar nga pandemia. Portali e-albania ishte pika kryesore ku u ofruan shërbimet gjatë kohës së pandemisë, periudhë gjatë së cilës ndër të tjera janë dhënë më shumë se 6 milionë leje, kjo e bërë e mundur falë investimeve për ndërlidhjen e back office me regjistrat kryesorë të integruar tashmë në portal.

ANEKS I

Përlidhje me vitin 2018 – 2022									
Nr. Aktivitetit	Detajimi i aktivitetit	Nr. i nën-aktivitetit	Detajimi i nën-aktivitetit	Institucioni raportues/ përgjegjës	Institucione të tjera përgjegjëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Mënyra e matjes së realizimit	Ecuria e zbatimit të aktiviteteve
Objektivi 1: Politikat planifikuese dhe koordinuese të përmbledhuara për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shprehin prioritetet në veprime konkrete									
